

Nr. Pr. 184/34

Dt. 11.09.17

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK Për Programin e studimit BSc në Shkenca juridike Universiteti Privat "Albanian University"

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Mirela Bogdani

2. Doc.Dr. Erind Merkuri

Korrik, 2017

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Shkenca juridike

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Albanian University
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	<p>Licensimi i programit: Shkresë (Urdhër) MASH Nr. 8981, datë 27.12.2005 (Si program studimi 4 vjeçar)</p> <p>Miratimi për planin e ndryshuar: Urdhër Nr. 295, datë 11.09.2009 (nga Bachelor 4-vjeçar në Bachelor 3-vjeçar)</p> <p>Me Shkresën Nr. 5695/1 Prot, datë 21.11.2012, u miratua akreditimi i programit të studimit Bsc Shkenca Juridike - 3vjeçar (sipas urdhërit të akreditimit të programit Bsc Shkenca Juridike - 4vjeçar)</p>
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	<p>Vlerësimi i parë për akreditimin: Urdhër Nr. 355, datë 03.11.2009 (Akredituar, me kusht sipas: VKA Nr. 50, datë 27.10.2009 - program studimi 4vjeçar)</p> <p>Vlerësimi në kuadër të heqjes së kushteve: Urdhër Nr. 541, datë 01.12.2010</p>
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Shkenca Juridike
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Numri i studentëve 2016 - 2017 2015 -2016	86 253

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Shkenca juridike

Programi i studimeve Bachelor në Shkenca juridike në Albanian University, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti Juridik, rezulton që të jetë hapur fillimisht me shkresën nr.8981, datë 27.12.2005, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas së cilës është miratuar, ndër të tjera edhe hapja e Fakultetit të Shkencave Shoqërore ku përfshihet dega "Shkenca juridike". Me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.295, datë 11.9.2009 (nr.5307 prot., datë 11.9.2009) "Për miratimin e programit të ndryshuar të Shkollës së Lartë Private "UFO UNIVERSITY", është miratuar programi i studimit 4 vjeçar në fushën e "Shkencave juridike".

Me vendimin e Këshillit të Akreditimit nr.50, datë 27.10.2009 "Për akreditimin e Programit të Studimit në Shkenca Juridike 4-vjeçar si dhe të Programeve të Studimit të Ciklit të Parë në: Financë – Bankë; Psikologji e Përgjithshme; Shkenca Komunikimi, të Shkollës së Lartë Universitare Private "UFO University", është rekomanduar, ndër të tjera akreditimi me kusht edhe i programit të studimit 4 vjeçar në Shkenca juridike në këtë institucion. Bazuar në këtë vendim ka dalë Urdhëri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.355, datë 3.11.2009 (nr.6362/1 prot., datë 3.11.2009) "Për akreditimin me kusht të disa Programeve të studimit të Shkollës së Lartë Universitare Private "UFO University". Sipas këtij urdhëri rezulton se programi i studimeve në fushën e Shkencave juridike që u akreditua ishte një program 4 vjeçar. Me vendimin e Këshillit të Akreditimit nr.99, datë 29.10.2009 "Për vlerësimin në kuadër të heqjes së kushteve të akreditimit për Fakultetin e Shkencave Shoqërore si dhe për programet e studimit të ciklit të parë (DNP/Bachelor) në: "Shkenca Politiko-Administrative"; "Financë-Bankë"; "Psikologji të Përgjithshme"; "Shkenca Komunikimi" dhe Programit të Studimit të Ciklit të Parë (4 vjeçar) në "Shkenca Juridike", të Shkollës së Lartë Universitare Private "UFO University", është rekomanduar heqja e kushtit të akreditimit edhe për programin e studimeve 4 vjeçar në fushën e "Shkencave juridike". Mbi bazën e këtij rekomandimi Ministri i Arsimit dhe Shkencës me Urdhërin nr.541, datë 1.12.2010 (nr.6861/1 prot., datë 1.12.2010), ka ndryshuar urdhërin e tij të mëparshëm, nga ku rezulton se për programin e studimit në fushën e Shkencave juridike 4 vjeçar, akreditimi është i plotë.

Nga RVB dhe nga intervista në institucion rezulton se ky program aktualisht, në pëpruthje me kërkesat e Kartës së Bolonjës është 3 vjeçar. Ky program studimi 3 vjeçar në fushën e Shkencave juridike, nuk rezulton të jetë akredituar, por sipas shkresës nr.5695/1, datë 21.11.2012, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, akreditimi që i është bërë programi 4 vjeçar të studimit është konsideruar i vlefshëm edhe për programin 3 vjeçar Bsc në "Shkenca juridike".

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Bordi i Akreditimit dhe ASCAL vendosën Prof.Asoc.Dr. Mirela Bogdani dhe Doc.Dr. Erind Mërkuri si ekspertë të jashtëm të vlerësimit të këtij program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit u asistuan nga specialistia i ASCAL, Xhiliola Bixheku.

Në datë 26. 07. 2017 dërgohet në Institucion Draf RVJ për programin e studimit Bsc. në Shkenca Juridike. Në datë 01. 08. 2017 Institucioni sjell pranë ASCAL komentet në lidhje me këtë program studimi. Komenten e IAL iu dërguan ekspertëve të vlerësimit, të cilët japin sqarimet si më poshtë në lidhje me to:

- PËRGJIGJE NDAJ KOMENTEVE TË ALBANIAN UNIVERSITY PËR DRAFT-RAPORTIN E VLERËSIMIT TË JASHTËM PËR PROGRAMIN E STUDIMIT BACHELOR NË "SHKENCA JURIDIKE"

➤ Për Standardin III.1. Kriteri 2.

Komentii Albanian University: Në RVB janë paraqitur të dhënat për vitin akademik 2015-2016, ndërsa për vitin akademik 2016-2017 stafi akademik i brendshëm ndonëse ka qenë në masën 70% ku një pjesë prej tyre (sic përmendet edhe në RVJ) ka qenë në fazën finale të mbrojtjes së

Gradës Shkencore ka kërkuar që të angazhohej më pak për mbulimin e ngarkesës për vetë impenjimin qëkërkon edhe konkludimi i studimit doctoral.

Përgjigje: Komenti nuk mund të merret në considerate pasi sic vetë pranohet nga Albanian University, për të paktën dy vite akademike (2015-2016 dhe 2016-2017), ngarkesa mësimore në masën 70% nuk është mbuluar nga PAE.

➤ **Për Standardin III.2 Kriteri 4.**

Komentii Albanian University: Në fakt, duke iu referuar kërkesës së kriterit 4, Departamenti ka staf me Gradë Shkencore për t'iu impenjuar si titullar të lëndëve në bazë të ligjit nr.9741 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Sipas kërkesës së vetë ligjit 80/2015 Departamenti ka marrë të gjitha masat për të përmbushur të gjitha standardet duke iu përshtatur ndryshimeve ligjore.

Përgjigje: Komenti nuk mund të merret në konsideratë, pasi pavarësisht kësaj përgjigje nuk tregohet nëpërmjet një dokumenti se cilët janë anëtarët e departamentit me gradë shkencore të cilët janë vendosur si titullarë të lëndëve përkatëse.

➤ **Për Standardin III.2 Kriteri 2.**

Komentii Albanian University: Duhet të sqarohet se mospërputhja e shifrave vjen si pasojë e ndryshimeve të të dhënave nga një vit në tjetrin të cilët janë ndikuar nga mbyllja dhe pezullimi i filialeve në Fier e Berat

Përgjigje: Komenti nuk mund të merret në konsideratë, pasi mbetet përsëri i paqartë se sa është realisht numri i stafit akademik për programin "Bachelor në Shkenca Juridike", si edhe sa prej tyre janë PAE dhe PAK.

➤ **Për Standardin III.3 Kriteri 3.**

Komentii Albanian University: Sqarohet që një pedagog udhëheqës nuk e cënon cilësinë e realizimit të praktikës profesionale pasi ajo zhvillohet e ndarë në grupe.

Përgjigje: Komenti nuk mund të merret në considerate pasi standardi shtetëror është i qartë në këtë drejtim (1 pedagog për çdo 12 studentë). Për më tepër organizimi i ndarjes së praktikës profesionale me grupe, ku të gjithë grupet janë në një pedagog, tregon se nga ana e studenteve nuk zhvillohet një ditë e plotë praktike profesionale, por vetëm disa ore, për deri sa një grup duhet të zëvendësohet nga një grup tjetër.

➤ **Për Standardin VII.2 Kriteri 1.**

Komentii Albanian University: Sic edhe theksohet ekzistojnë një sere marrëveshjesh edhe me institucione të tjera publike apo private, por zhvillimi i praktikës vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë është një zgjedhje e vetë studentëve.

Përgjigje: Komenti nuk mund të merret në konsideratë, pasi si nga intervista e zhvilluar në institucion, ashtu edhe nga përshkrimi që i është bërë llojit të marrëveshjes në RVB (tabela nr.21, fq.79-80) nuk rezulton që këto marrëveshje me institucionet e tjera të kenë si qëllime dhe realizimin e praktikës profesionale.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Këshilli i Akreditimit nuk ka lënë rekomandime për t'u plotësuar për programin e studimit Bachelor në Shkenca Juridike.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Programi Bachelor në "Shkenca Juridike" i "Albanian University" i akredituar me Urdhër nr. 541, dt. 01.12.2010 (*Vlerësimi në kuadër të heqjes së kushteve / VKA Nr. 99, datë 29.10.2010* ofron formim bazë të përgjithshëm në të tre drejtimit kryesore të tyre: civil, penal dhe publik.

Misioni i programeve të studimit në përgjithësi, përfshi programin për të cilin kërkohet akreditim është reflektuar tek faqja e internetit të IAL, së bashku me vlerat ku ata besojnë dhe kanë ndërtuar programin¹.

Programet e studimit të AU, përfshirë edhe programin Bachelor në Shkenca Juridike, synojnë të zhvillojnë dhe zgjerojnë dimensionet e dijeve të studentëve përmes arsimimit cilësor në fushën e së drejtës, përshtirjes sociale e kulturore të tyre në dobi të komunitetit, synojnë të nxisin mendimin kritik, aftësitë krijuese, bazuar tek etika akademike dhe zhvillimet bashkëkohore të shkencës dhe disiplinave të tjera shoqërore. Qëllim i programit është edhe bërja e tij sa më kompetitiv për t'i përgatitur juristët e ardhshëm për tregun e punës.

Objektivat e IAL dhe programit Bachelor në Shkenca Juridike, janë kryesisht afatgjata për një përgatitje të plotë, të përshtatshme dhe konkurruese në tregun shqiptar por edhe atë rajonal të studentëve që diplomohen. Megjithatë IAL ka edhe objektiva afat-mesme dhe afat-shkurtra në përgatitjen e përgjithshme dhe praktike apo profesionale bazike të të dilomuarve në ciklin e parë të studimeve, që janë kontigjent i gatshëm për tregun e punës, me tendencën për t'i përfshirë në një të ardhme të afërt edhe në ciklin e dytë të studimeve (*nivel Master*) pasi ata të jenë punësuar, ose edhe më tej në ciklin e tretë të studimeve (studime doktorale).

IAL "Albanian University" ka objektiva të plota e të qarta afat-gjata, afat-mesme dhe afat-shkurtra, në përputhje me zhvillimet e tregut dhe të shoqërisë. IAL gjithashtu ka në fokus edhe kërkimin shkencor, i cili fillon që në ciklin e parë të studimeve dhe merr trajtë të plotë në studimet në nivel masteri. Në këtë kontekst mund të thuhet se plotëson standardet lidhur me misionin, objektivat e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Kriteri 1 Programet e studimeve BSc në Shkenca Juridike janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe objektivat afatshkurtra, afatmeseme dhe afatgjata, pasi reflektojnë modulet kryesore të formimit të studentit në disiplinën/shkencën e së drejtës si dhe module plotësuese të lëndëve me zgjedhje, që i plotësojnë interesat e tyre në varësi të profileve dhe temave specifike dhe janë përshtatur me kapacitetet akademike të institucionit.
Kriteri 2 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	Kriteri 2 Programet e studimeve BSc në Shkenca Juridike, nga verifikimet që ju bënë si dhe nga
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen	

¹ Për më shumë referohu tek faqja zyrtare e IAL 'Albanian University' <http://albanianuniversity.edu.al/sq/misioni-dhe-vlerat/>

<p>në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>takimet e zhvilluara në institucion me pedagogë dhe studentë (përfshirë edhe studentë të cilët ishin diplomuar nga ky program) reflektojnë objektiva të artikuluar qartë, që lidhen plotësisht me profilin e programit, duke mundësuar mësim-dhënien dhe mësim-nxënien me kompetencë profesionale. Programet reflektojnë plotësisht misionin dhe objektivat e përgjithshëm të IAL 'Albanian University' lidhur me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (për aq sa mund tja lejojnë programet e ciklit të parë). Këto objektiva përfshijnë rritjen e dijeve dhe niveli të informacionit, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të ketë një jurist i diplomuar në përfundim të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3 & 4 Programet e studimit BSc në Shkenca Juridike ofrojnë një formim të përgjithshëm të studentit në module që reflektojnë kryesisht ndarjet e së drejtës në fushën publike, civile dhe atë penale - kjo u mundëson studentëve përshtatjen lehtësisht në programe të mëtejshme të avancuara studimi të ciklit të dytë e më tej, si në Shqipëri edhe jashtë.</p> <p>Formimi i përgjithshëm në këtë program krijon lehtësi përshtatje edhe në tregun e punës, megjithatë në Shqipëri mungojnë të dhënat e sakta e të plota në nivel institucionesh shtetërore për kërkesat e tregut të punës, dhe konsiduar edhe faktin që shumica e studentëve që mbarojnë studimet BSc vazhdojnë edhe më tej programe të ciklit të dytë, arrijmë natyrshëm në përfundimin që është e vështirë të realizosh në terrenin shqiptar një analizë të saktë e të plotë të nivelit të suksesit të kurrikulave të një programi që ofrohet.</p> <p>Programet e studimit dhe metodat e mësimdhënies kanë ndryshuar në përputhje me zhvillimet dhe nevojat konkrete të tregut të punës dhe zhvillimeve të shoqërisë, duke përfshirë module që janë koherente.</p> <p>Programet e studimit BSc në Shkenca Juridike, duke qenë të përgjithshme për formimin e një juristi, mund të thuhet pa hezitim që plotësojnë nevojat për zhvillimin e një vendi - sa i takon zhvillimit ekonomik, është e vështirë të realizohet një analizë e tillë, pasi mungojnë të dhënat për kërkesat e tregut të punës, për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të</p>	<p>Kriteri 1 Programet e studimit BSc në Shkenca Juridike rezultojnë që përshtaten plotësisht me Strategjinë për zhvillimin e institucionit, me misionin, vizionin e tij si dhe objektivat afat-gjata, afatshkurtra dhe afat-mesme.</p> <p>Kriteri 2 & 3 Programet e studimit BSc në Shkenca juridike, nga sa u përmend edhe më sipër janë kurrikula që ofrojnë në një shkallë të lartë njohuri të përgjithshme lidhur me tre fushat kryesore të së</p>

<p>parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>drejtës (publike, civile dhe penale). Nëse i referohemi programit të studimit, lëndët me zgjedhje dhe Praktika Mësimore ofrojnë edhe njohuri praktike.</p>
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Kriteri 1 & 2 Programet e studimit BSc në Shkenca Juridike ofrojnë një formim të përgjithshëm të studentit në module që reflektojnë kryesisht ndarjet e së drejtës në fushën publike, civile dhe atë penale - kjo u mundëson studentëve përshtatjen lehtësisht në programe të mëtejshme të avancuara studimi të ciklit të dytë e më tej, si në Shqipëri edhe jashtë. Formimi i përgjithshëm në këtë program krijon lehtësi përshtatje edhe në tregun e punës, megjithatë në Shqipëri mungojnë të dhënat e sakta e të plota në nivel institucioneve shtetërore për kërkesat e tregut të punës, dhe konsiduar edhe faktin që shumica e studentëve që mbarojnë studimet BSc vazhdojnë edhe më tej programe të ciklit të dytë, arrijmë natyrshëm në përfundimin që është e vështirë të realizosh në terrenin shqiptar një analizë të saktë e të plotë të nivelit të suksesit të kurrikulave të një programi që ofrohet.</p> <p>Sic u informuan nga stafi i programit, dhe sic reflektohet edhe nga aktivitetet e shfaqura në faqen e internetit, institucioni realizon takime me ekspertë të ndryshëm të cilët paraqesin eksperiencat e tyre lidhur me sfidat e tregut të punës, organizon 'Panairin e Karrierës' (http://albanianuniversity.edu.al/sq/1794-2/) ku studentët të vizitojnë tendat e kompanive, institucioneve dhe organizatat me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi dhe më pas të ftuarit së bashku diskutojnë në një tryezë të rrumbullakët; nëpërmjet diskutimeve, asistencës dhe konsultimeve, ata japin një mbështetje shumë e madhe për programet e studimit të ofruara në drejtim të ruajtjes së lidhjeve dhe tendencave nga tregu i punës.</p>
<p>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Kriteri 1 & 2 Programet e studimit BSc në Shkenca Juridike, nuk u vu re në asnjë rast që të binin ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Nga ana formale interesat kombëtare mbrohen dhe proklamohen nëpërmjet misionit dhe vizionit të IAL. Në rrafshin praktik u vu re (në diskutim me studentët dhe pedagogët e programit) që janë organizuar aktivitete në kuadrin e reformës në Shkenca juridike, një sipërmarrje kjo me vlerë kombëtare pasi synon përmirësimin rrënjësor të sistemit të drejtësisë shqiptare, në përputhje me standardet, praktikat dhe vlerat evropiane- diskutimi i këtyre çështjeve në konferenca apo aktivitete me studentët reflekton qytetari dhe patriotizëm dhe motivimin për të ruajtur vlerat e mira kombëtare dhe për të avancuar me tej drejt atyre evropiane.</p>

Konkluzione të GVJ:

Në përfundim, vlerësohet se Programi i studimit BSc në Shkenca Juridike është hartuar në përputhje me kërkesat dhe standardet e Ligjit 'Për Arsimin e Lartë', në përputhje më kërkesat e Kartës së Bolonjës për formim të përgjithshëm në studimet e ciklit të parë, reflekton plotësisht formimin teorik të studentit por edhe atë praktik nëpërmjet lëndës së praktikës profesionale dhe lëndëve me zgjedhje. Programet mësimore, stafi akademik por edhe aktivitetet e organizuara nga stafi i programit reflektojnë tendencën për të ecur njëkohshëm me zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe me zhvillimet e rajonit e më gjerë. Ato gjithashtu reflektojnë kultivimin, nxitjen dhe transmetimin e vlerat kombëtare gjatë procesit të mësimdhënies/nxënies por edhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera shkencore dhe profesionale.

Në këtë këndvështrim standardet plotësohen tërësisht.

Sugjerim - Aktivitetet shkencore dhe profesionale që janë zhvilluar nga studentët dhe pedagogët e Programit BSc në Shkenca Juridike që reflektojnë edhe vlera kombëtare, mund të gjejnë pasqyrim më të plotë në faqen e internetit të IAL 'Albanian University'.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjëse për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Bazuar në raportin e vetëvlerësimit të paraqitur nga "Albanian University", nga verifikimi në vetë institucionin si edhe intervistat me drejtuesit e këtij institucioni, rezulton se ky institucion është i organizuar në tre fakultete, në atë të Shkencave Mjekësore dhe në atë të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe në atë të Shkencave Shoqërore.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, përbehet nga katër njësi bazë dhe më konkretisht nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, nga Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative dhe nga Departamenti i Shkencave Juridike.

Sipas RVB rezulton se struktura e Fakultetit ruan ende organizimin sipas legjislacionit të vjetër të arsimit të lartë kështu përveç njësive bazë të sipërcituara, rezulton se ende është funksional Këshilli i Fakultetit.

Në institucion funksionon edhe Qendra e kërkimit shkencor, e organizuar si njësi kryesore e cila është përgjegjëse për realizimin e studimeve dhe kërkime shkencore. Qendra harton dhe zbaton programe dhe projekte kërkimore. Qendra projekton e zbaton lidhje e marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera, publike ose private, brenda dhe jashtë vendit, si dhe me shoqata, fondacione etj, zhvillon konferenca, simpoziume, forume shkencore, tryeza diskutimesh etj, universitare, ndëruniversitare dhe ndërkombëtare.

Përsa i përket dokumentacionit, në lidhje me këtë pjesë, rezulton se ishte vënë që në fillim në dispozicion nga ana e Albanian University dhe është ngarkuar edhe në platformen elektronike ASCAL.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Përsa i përket strukturës didaktike, sic e përmendem më sipër Fakulteti i Shkencave Sociale ndahet në katër njësi bazë dhe më konkretisht në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes, në Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, në Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative dhe në Departamentin e Shkencave Juridike. Kjo struktura e fundit është përgjegjëse për ofrimin e programeve studimore në shkencat juridike dhe nuk rezultojnë që të jenë organizuar në nëndarje të tjera.

Përsa i përket numrit të personalit akademik efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK) të dhënat e vetëdeklaruarra dhe ato të verifikuara në institucion rezultojnë se në RVB janë deklaruar 45 anëtarë të stafit akademik, nga të cilët 12 anëtarë janë PAE dhe 33 anëtarë janë PAK (Tabela nr.1, fq.14-15 e RVB). Sipas tabelës nr.3 në RVB, fq. 19-20, rezultojnë 15 anëtarë PAE dhe 19 anëtarë PAK. Ndërkohë sipas dokumentit të titulluar “të dhëna zyrtare të burimeve njerëzore”, rezultojnë 14 anëtarë PAE dhe 11 anëtarë PAK. Kjo e dhënë e fundit përputhet edhe me dokumentin tjetër të titulluar ““Profili i pedagogut, lendet dhe ngarkesa per prog.st..pdf””, pra në total 25 pedagogë. Në dokumentin tjetër “Tabela Titullarë-Pedagogë”, rezultojnë në total 33 anëtarë (PAE dhe PAK). Pra rezultojnë një sërë të dhënash që japin informacione të ndryshme në lidhje me numrin e personalit akademik i cili ushtron detyrat e tij pranë këtij Institucioni në programin e Shkencave Juridike.

Sipas Tabelës nr.1 në RVB, Departamenti i Shkencave Juridike ka një staf akademik prej 45 anëtarësh të cilat ndahen si më poshtë:

Personel akademik efektivë janë 12 anëtarë, nga të cilët 4 janë me grada/tituj (1 Profesor i Asociuar, 3 Doktorë).

Personel akademik me kontratë janë 33 anëtarë, nga të cilët 17 janë me grada/tituj (5 Profesorë Doktorë, 4 Profesorë të Asociuar, 8 Doktorë)

Departamenti mbështetet edhe nga një personel administrative prej 9 anëtarësh, nga të cilët sipas RVB, 2 prej tyre aktivizohen në mësimdhënie.

Sipas Tabelës nr.3 në RVB, rezultojnë 15 anëtarë PAE (1 Prof.Asoc., 6 Dr.) dhe 19 anëtarë PAK (3 Prof.Dr., 3 Prof.Asoc., 2 Dr.)

Sipas dokumentit të titulluar “të dhëna zyrtare të burimeve njerëzore”, rezultojnë 14 anëtarë PAE (1 Prof.Asoc., 7 Dor.) dhe 11 anëtarë PAK (2 Prof.Dr., 3 Prof.Asoc., 1 Dr.).

Për këtë arsye nuk është e mundur të plotësohen edhe tabelat përkatëse që i bashkëlidhen si ankes këtij raporti, pasi ka mospërputhje.

Megjithëse në RVB përmenden statistika në lidhje me moshën dhe gjininë, duke qenë se të dhënat për anëtarët e personalit akademik efektiv dhe me kontratë janë të ndryshme, sic u analizua më sipër, atëherë, nuk rezultojnë e mundur të jepen të dhëna të sakta në lidhje me këto dy elementë.

Në lidhje me cilësinë e stafit ndihmës/administrativ, rezultojnë se Departamenti i Shkencave Juridike, sipas deklaramentit në RVB, ka staf administrativ të mjaftueshëm, prej 9 anëtarësh, i cili mbështet nëpërmjet veprimtarisë teknike, administrative dhe materiale, stafin akademik, si edhe mirëfunksionimin e shërbimeve të tjera në këtë institucion.

Përsa i përket dokumentacionit, përveç atij të vënë që në fillim në dispozicion dhe të ngarkuar në platformën elektronike ASCAL për këtë pjesë nga ana jonë u kërkuar dhe u vunë në dispozicion edhe këto dokumenta:

1. Raporti vjetor dep. Shkencave Juridike 2015-2016
2. Raport vjetor i Fakultetit të Shkencave Shoqërore 2015-2016
3. Njoftim për trajnimin e stafit akademik
4. Axhenda e trajnimit të stafit akademik
5. Temat e trajnimit 2016-2017
6. Model raporti vetëvlerësimi i pedagogut për procesin mësimor
7. Model formulari i deklaramentit të veprimtarive kërkimore - shkencore të personelit akademik
8. Dokument për vlerësimin e performancës së stafit nga drejtuesi i Departamentit
9. Model pyetësori i studentëve

10. Kontrate Pedagog efektiv
11. Kontrate Pedagog me kontrate
12. Kontrate Sherbimi
13. Kontrate staf administrativ
14. Printscreen - publikimi i vendeve vakante
15. Procedura e rekrutimit te stafit
16. Profili i pedagogut, lendet dhe ngarkesa per program studimi
17. Tabela titullare - pedagoge
18. Stafi akademik per levizshmerine.
19. Te dhena Zyra e Burimeve Njerezore
20. Përmbajtja e dosjes

Dokumentacioni i kërkuar rezultoi i plotë dhe në përputhje me standardet ligjore..

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Kriteri 1. Rekrutimi i personelit është kryer në përputhje me legjislacionin që ka qenë në fuqi për arsimin e lartë dhe Kodin e Punës. Po kështu rezulton se janë respektuar kërkesat e statutit dhe të Rregullores së Institucionit. Shpallja për vendet vakante është bërë publike në faqen e internetit të institucionit. Procesi kalon në një procedurë vlerësimi paraprak dhe më pas intervestimi nga Komisioni ad hoc që ngrihet për këtë qëllim.</p> <p>Kriteri 2. Sipas RVB anëtarët e personalit akademik efektiv përbëjnë më shumë se 70% të personelit të angazhuar. Por nga verifikimi në terren rezulton ndryshe. Kështu bazuar në të dhënat e dokumentit “Profili i pedagogut, lendet dhe ngarkesa per prog.st..pdf”, rezulton se orët mësimore të zhvilluar në total janë 3425, nga të cilat 1950 orë (afërsisht 57%) janë zhvilluar nga personel akademik efektiv dhe 1475 orë (afërsisht 43%) janë zhvilluar nga personeli akademik me kontratë.</p> <p>Kriteri 3. Në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, ndiqet në procedurë vlerësimi e personelit akademik i cili përshin të dhënat që vijnë nga pyetësori i studentëve, të dhënat e të cilave përpunohen nga ana e NJBSC, si edhe nga vlerësimi i përgjegjës të departamentit. Të gjitha këto të dhëna bëhen pjesë e një analize vjetore në çdo department.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni mban një bazë të të dhënave të raporteve të rekrutimit të personelit, si edhe të njoftimeve për punë.</p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin</p>	<p>Kriteri 1. Nga kontrolli në njësinë e burimeve njerëzore, rezultoi se të gjithë anëtarët e personelit akademik kishin dosjen e tyre personale në të cilën gjendeshin Dokumenti i identitetit, Dokumenti që vërteton punën e kryer me pare, Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore, Diploma Universitare dhe lista e notave, Diploma dhe dokumente të tjera te gradave dhe titujve shkencore,</p>

<p>semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>si dhe të kualifikimeve të tjera, Libreza shëndetësore, Adresa e vendbanimit, jetëshkrimi.</p> <p>Kriteri 2. Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion rezulton se dispozohen disa të dhëna në lidhje me pedagogët por, këto të dhëna sic u arsyetua në pjesë përshkruese më sipër, kanë mospërputhje midis tyre.</p> <p>Kriteri 3. Nga verifikimi i praktikave të punësimit në institucion, rezulton ky institucion i publikon kriteret e punësimit të personelit akademik.</p> <p>Kriteri 4. Nga verifikimi në institucion, rezulton se titullarë të këndëve që aktivizohen nga Institucioni janë anëtarë të personelit akademik me titull Profesor dhe Profesor i Asociuar. Megjithatë rezulton që nga titullarët e personalit akademik vetëm njëri prej tyre është anëtar i Departamentit të Shkencave juridike me kohë të plotë. Të tjerat rezultojnë të jenë PAK, ose anëtarë të departamenteve të tjera. Gjithashtu një pjesë e pedagogëve janë në proces të kualifikimit shkencor (doktoraturë).</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Kriteri 1. Studentëve u vihen në dispozicion kompjutera portabël në ambiente të posacme, si edhe mësimdhënia mundësohet nëpërmjet projeksioneve, videoprojektorëve dhe materialeve në poërpoinit. Po kështu në ambientet e institucionit ka paisje të ndryshme si printera, skanera, etj, të cilat mbështesin procesin e mësimdhënies.</p> <p>Kriteri 2. Megjithëse të dhënat nuk përputhen midis tyre, duke marrë numrin minimal që rezulton nga të dhanët e administruara, mund të themi që institucioni angazhon personel të mjaftueshëm për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Përsa i përket praktikës mësimore nuk rezulton që kriteri të përputhet. Sipas RVB dhe intervistave në institucion, rezulton se vetëm një pedagog mbulon praktikën mësimore, ndërkohë që viti i tretë në programin BSc ka rreth 70 studentë.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Kriteri 1. Në lidhje me këtë kriter rezulton se për kualifikimin e mëtejshëm të vetë stafit akademik nga ana e institucionit janë ndjekur këto politika: a) organizimin e konferencave shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, b) publikimin e artikujve në revistën shkencore të institucionit, c) në disa raste, mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në aktivitete me karakter shkencor jashtë vendit, ç) publikimin e botimeve shkencore të stafit akademik ka vetë institucioni me fondet e tij.</p> <p>Kriteri 2. Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion rezultoi se pranë tij ndodhesh një baze e plotë e të dhënave të programeve të studimit të ofruara. Ato gjenden pranë departamentit</p>

Konkluzione të GVJ:

Albanian University ndjek procedura të rregullta dhe transparente të punësimit të personelit. Nuk ka të dhëna të qarta dhe të plota se sa është numri i personalit akademik efektiv apo me kontratë që shërben në Departamentin e Shkencave Juridike. PAE nuk përbën 70% të angazhuar në procesin e mësimdhënies. Midis anëtarëve të stafit akademik, ka pedagogë të kualifikuar dhe me përvojë të cilët kanë edhe tituj dhe grada shkencore. Megjithatë rezultojnë që në pjesën më të madhe të rasteve, titullarët e lëndëve nuk janë pjesë e Departamentit si personal akademik efektiv. Ndërkohë që ka edhe pedagogë të tjerë, të rinj të cilët janë në proces kualifikimi. Nuk ka një ndarje sipas kriterëve të pedagogëve që ndjekin praktikën mësimore.

Institucioni zbaton mekanizma kontrolli që monitorohen dhe përpunohen nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe diskutohen periodikisht me autoritetet drejtuese. Institucioni disponon të dhëna të plota për aktivitetin e të gjithë pedagogëve dhe procesit të mësimdhënies. Institucioni disponon të dhëna të plota për programet e studimit që ofron; ato u vihen në dispozicion studentëve në çdo kohë.

Standartet plotësohen pjesërisht.

Sugjerime – Përcaktimi i qartë i numrit të personelit akademik efektiv apo me kontratë i cili zhvillon procesin mësimor në institucion.

Rritjen e numrit të PAE me qëllim angazhimit të tyre në mbi 70% të procesit mësimor.

Titullarët e lëndëve duhet që të jenë pjesë e personelit akademik efektiv.

Duhet të caktohen më shumë pedagogë për praktikën mësimore me qëllim arritjen e standardeve.

Duke qenë se institucioni investon në forma të ndryshme në rritjen e kualifikimit shkencor dhe profesional të stafit akademik, sugjerohet që në kontratën e punës individuale të parashikohet një klauzolë që anëtari i personelit akademik do të qëndrojë mbas marrjes së gradës/titullit shkencor edhe për një periudhë kohore të caktuar pranë këtij institucioni arsimor.

Programet e studimit duhet të vendosen në faqen e internetit të institucionit në mënyrë që, si studentët ashtu edhe persona të tjerë të interesuar të kenë akses në to.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Mjediset për programin e studimit BSc në Shkenca Juridike në IAL 'AU' rezultuan të jenë mjaft të përshtatshme për të realizuar procesin mësimor. Gjatë vizitës në universitet pamë sallat e leksioneve, klasat ku zhvillohen seminarët, një auditorium mjaft i madh ku janë zhvilluar dhe mund të zhvillohen edhe në të ardhmen aktivitete të rëndësishme shkencore dhe me profil të gjerë mediatik. Në katin përdhësë ishte vendosur Biblioteka e cila mjaft mirë mund të përdoret jo vetëm për të shfrytëzuar literaturë në trajtën e materialeve të printuara (*hard copy*) por edhe në versionin elektronik me bibliotekën online 'Questia'. Në dispozicion të studentëve në ambientin e Bibliotekës ishte konceptuar edhe një kënd studimor komod në mënyrë që literarura të mund të shfrytëzohet edhe në sallë. Biblioteka ishte e pajisur edhe me disa kompjutera të lidhur me internet, nga ku studentët mund të aksesojnë emailin, printojnë materiale apo realizojnë kërkime shkencore. Lidhur me ambientin ku është përshtatur biblioteka, konstatoam se ambienti për shkak të vendodhjes në katin përdhësë kishte lagështirë, ndaj rekomandojmë që në të ardhmen ky ambient të përshtatet për kushtet e leximit dhe të ruajtjes së librave në kushte lageshtie optimale.

Në ambientet e universitetit nuk mungonte as një vend i dedikuar për printime, fotokopje, etj. Vizituam gjithashtu edhe mjediset për stafin (*një nga këto ambiente ju vu edhe në dispozicion Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për të zhvilluar takimet e programuar në universitet*) - ato rezultuan mjaft komode dhe të përshtatshme për stafin (*Dekanin, pedagogët/personelin akademik*), për Qendrën Kërkimore e Shkencore si dhe për stafin administrativ. Një vizitë e vecantë u realizua në sekretarinë mësimore; kushtet e punës të sekretarisë mësimore rezultuan mjaft të përshtatshme.

Lidhur me laboratorët rezultojnë se në disiplinën e së drejtës nuk ka ndonjë kërkesë specifike për to, por *bazuar edhe në eksperiencën e universiteteve të tjera do të rekomandonim që një nga sallat e vogla të seminareve të mund të organizohet në formën e një salle gjyqi, ku të mund të improvizoheshin seanca gjyqësore, apo të realizoheshin 'mocket trial' gjyqe imituese. Një*

klinikë/laborator i tillë do t'i shërbente studentëve të ciklit të parë të studimeve bachelor, përpos atyre që studiojnë në ciklin e dytë të nivelit Master; gjithashtu kjo mund të koordinohet apo implementohet lehtësisht në kuadrin e një moduli të veçantë si Klinika Ligjore.

Zyra/Këndi i Informacionit gjithashtu është e vendosur në katin e parë dhe zë një hapësirë të konsiderueshme të tij; këndi i informacionit për studentët si dhe për kandidatët potencialë që interesohen të studiojnë në këtë universitet është jo vetëm i madh në sipërfaqe por edhe mjaft mirë i areduar e i furnizuar me broshura të shumta informative, pasi është pjesa më e përshtatshme për të realizuar marketingun e programeve.

Infrastruktura e universitetit është e përshtatshme për të zhvilluar programin BSc në Shkenca Juridike, duke filluar që nga vendodhja në qendër të qytetit, e duke vijuar me sallat, pajisjet, mobilimin, etj.

Teknologjia e Informacionit është bashkohore. Në sallat e leksioneve janë instaluar projektorë që e bëjnë mjaft më të thjeshtë procesin e mësimdhënies dhe diskutimeve/debateve.

Shërbime të tjera për Studentët - Në katin e parë të godinës gjendet edhe një kafene mjaft komode e cila natyrshëm mund të përdoret nga studentët për takimet e tyre, diskutime të shkurtra, mund të shërbejë në disa pjesë edhe si hapësirë leximi. Aty ofrohen edhe shërbime 'snaks' pra gatime/ushqime të shpejta që mund t'u vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit.

Rezidencat - Gjatë vizitës në universitet u informuam se 'AU' ka pasur operative një godinë fjetjeje (*konvikt*) për studentët që vijnë nga rrethet, por që nuk është më aktive.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm

Në tërësi, lidhur me mjediset e universitetit, nga vizita në institucion rezultuan se ambientet në funksion të procesit mësimor të programit BSc në Shkenca juridike ishin të përshtatshme dhe në përputhje të plotë me të dhënat sasiore dhe treguesit e paraqitur në RVB, të dorëzuar nga Institucioni.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e</p>	<p>Kriteri 1 Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion rezulton se në dispozicion të studentëve ekziston e gjithë literatura bazë dhe materialet ndihmëse për cdo lëndë. Më konkretisht cdo tekst mësimor apo material tjetër i përmendur në programet e studimit ndodhet i aksesueshëm për studentët. Nga vizita në institucion u informuam se gjatë viteve 2015-2017 janë blerë 25 tituj librash të rinj që lidhen me programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2 Nga verifikimi në institucion rezulton se në bibliotekën e institucionit ekziston e gjithë literatura e nevojshme për realizimin e programit të studimit nga ana e studentëve.</p> <p>Kriteri 3 Universiteti ka një Bibliotekë, në një hapësirë të konsiderueshme që gjendet në katin përdhës të godinës. Biblioteka ofron akses mjaft të mire fizik por edhe mundësi leximi në sallë. Nga vizita në institucion, rezultoi se ka një person të dedikuar me kohë të plotë që është në dispozicion të lexuesve, për orientim të studentëve për kërkimin e teksteve, për vënien në dispozicion të listës së</p>

<p>shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>botimeve/teksteve dhe kërkimin e literaturës në fushat specifike të së drejtës. Biblioteka ofron edhe shërbimin e internetit që studentët mund ta shfrytëzojnë për kërkime të specializuara, dhe qëndron e hapur të gjitha ditët e javës (orari 08: 00-16: 00, ditën e shtunë orari 08: 00-12: 00, kurse dita e diel është pushim).</p> <p>Biblioteka ofron botime periodike si dhe librarinë elektronike 'Questia' (https://ëëë.questia.com/member-login), të cilat përmbanin libra dhe revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, si dhe projekteve kërkimore shkencore për përgatitjen e tezës së studentëve.</p> <p>Nga vizita në universitet dhe takimet me pedagogët dhe stafin mbështetës/administrativ na u komunikua se ka filluar të zbatohet një praktikë ku departamentet hartojnë lista me kërkesa për libra/botime të reja, së bashku me kostot përkatëse. Këto kërkesa kalojnë më pas tek Bordi Administrativ për t'u diskutuar nga pikëpamja financiare dhe për t'u realizuar.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Kriteri 1 & 2 Universiteti rezultoi se ofronte ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimeve, kryesisht në trajtën e sallave të leksioneve dhe seminareve, si dhe hapësirave ku mund të zhvillohen edhe debate/diskutime publike që mund të regjistrohen dhe të transmetohen edhe në media.</p> <p>Kriteri 3 & 4 Lidhur me laboratorët rezulton se në disiplinën e së drejtës nuk ka ndonjë kërkesë specifike për to. Bazuar edhe në eksperiencën e universiteteve të tjera do të rekomandonim që një nga sallat e vogla të seminareve të mund të organizohet në formën e një salle gjyqi, ku të mund të realizoheshin seanca gjyqësore, apo të realizoheshin 'mocket trial' gjyqe imituese. Një klinikë/laborator i tillë do t'i shërbente studentëve të ciklit të parë të studimeve bachelor, përpos atyre që studiojnë në ciklin e dytë të nivelit Master; gjithashtu Klinika Ligjore mund të koordinohet apo implementohet lehtësisht në kuadrin e një moduli të veçantë.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni disponon kompjutera për përdorim nga studentët e programit kryesisht në bibliotekën e IAL; atyre u krijohet mundësia që nëpërmjet kompjuterave protabël të kenë akses në librarinë elektronike Questia si edhe në internet.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera private mjediset për zhvillimin e praktikave profesionale, të cilat janë të mjaftueshme për studentët e programit BSc në Shkencë Juridike.</p>
--	---

Konkluzione të GVJ:

Institucioni ka vendodhje të përhershme, afatgjatë ku zhvillohet kryesisht veprimtaria mësimore, kërkimi shkencor, organizimi i takimeve profesionale si dhe pjesa kryesore e veprimtarisë mbështetëse administrative. Institucioni ofron ambiente të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimeve, kryesisht në trajtën e sallave të leksioneve dhe seminareve, si dhe hapësirave ku mund të zhvillohen edhe debate / diskutime publike që mund të regjistrohen dhe të transmetohen edhe në media.

Në institucion ndodhet e gjithë literatura e nevojshme bazë për zhvillimin e procesit të mësimdhënies për të gjitha lëndët. Universiteti ka një Bibliotekë të dedikuar shkencave humane, ku përfshihet edhe disiplina e drejtësisë. Biblioteka ofron akses mjaft të mirë fizik por edhe mundësi leximi në sallë; aty ka një person me kohë të plotë që është në dispozicion të lexuesve, Biblioteka ofron shërbimin e internetit dhe akses në kompjutera që studentët mund ta shfrytëzojnë për kërkime të specializuara.

Biblioteka ofron botime periodike si dhe librarinë elektronike 'Questia' që përmban libra dhe revista shkencore të nevojshme për programin e studimit.

Standardet plotësohen tërësisht.

Sugjerim - Bazuar edhe në eksperiencën e universiteteve të tjera do të sugjerim që një nga sallat e vogla të seminareve të mund të organizohet në formën e një salle gjyqi, ku të improvizoheshin seanca gjyqësore. Një klinikë/laborator i tillë do të shërbente studentëve të ciklit të parë të studimeve bachelor, përpos atyre që studiojnë në ciklin e dytë të nivelit Master; Klinika Ligjore mund të koordinohet apo implementohet lehtësisht në kuadrin e një moduli të veçantë.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Burimet e financimit - Në programin BSc në Shkenca Juridike u informuam se burimet e financimit vijnë kryesisht nga pagesat e shkollimit të studentëve. Universiteti mban bilance të rregullta lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e programeve të studimit si dhe ka informacion të plotë lidhur me menaxhimin e burimeve financiare dhe kontrollin e tyre. Në raport mungojnë të dhënat lidhur me të ardhurat e programit, por ka të dhëna në % lidhur me shpenzimet që konsistojnë në:

- shpenzime për fondin e pagave (rreth 50 % të shpenzimeve)
- fondin për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore,
- pagesat për honorate mësimdhënie (që përbëjnë rreth 6 % të të ardhurave),
- fonde për shpenzime kancelarie si dhe
- fonde për veprimtari shkencore & fondin e ekselencës (që zë rreth 5 % të të ardhurave).

Institucioni ka raporte financiare për çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të hartuar dhe çertifikuar nga ekspertë të jashtëm. Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

Lidhur me **grantet për kërkim** u informuam se institucioni nuk ka përfituar asnjë grant të huaj apo nga kontratat e shërbimeve dhe nuk ka asnjë të ardhur nga konsulentat apo donacionet/sponsorizime. Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti tregtar, të dhënat janë llogaritur si të ardhura për universitetin në tërësi, dhe jo vetëm për programe të caktuara.

Lidhur me treguesin e llogaritjes së **koshtos për student**, nuk e konstatoam të llogaritur në ndonjë dokument specifik, por bazuar në dokumentacionin financiar që na u vu në dispozicion si edhe në të dhënat e RVB për llogaritja e saj është e mundur duke pjesëtuar shpenzimet totale të programit me numrin e studentëve që kanë frekuentuar programin.

Kapacitetet menaxhuese të universitetit rezultuan efektive si nga bisedat që zhvilluam në institucion ashtu edhe nga dokumentat dhe analizat e paraqitura në RVB; në pasqyrat financiare të vëna në dispozicion rezultonte që më tepër se 65 % e të ardhurave nga tarifat e shkollimit



shpenzohet për paga, honorare, veprimtari shkencore dhe fond ekselence, pra shkon për studentin.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Treguesit e matshëm rezultuan të jenë në % - aty paraqiten kryesisht shpenzimet lidhur me programin e studimit, megjithatë gjatë vizitës në institucion u informuam se këto të dhëna gjendeshin të plota tek Zyra e Financës si dhe në raportet financiare vjetore të Institucionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Kriteri 1 - Institucioni realizon auditim të përvitshëm të situatës së tij financiare, në varësi të të ardhurave, të cilat vijnë kryesisht nga tarifat e studimit. Ky është një detyrim financiar që kërkohet edhe nga legjislacioni tatimor në fuqi, ndaj auditimi i brendshëm dhe i jashtëm është një proces që realizohet çdo vit.</p> <p>Kriteri 2 - Raportet financiare përmbajnë të gjitha elementët/zërat financiarë lidhur me të ardhurat dhe me shpenzimet.</p> <p>Kriteri 3 - Raporti nuk përmban informacion financiar lidhur me Grantet apo të ardhura të tjera që mund të jenë përfituar nga kontratat e shërbimeve. Nga intervista në institucion rezulton se as IAL dhe as Programi BSc në Shkenca Juridike nuk ka pasur përfitime të tilla.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Kriteri 1 & 2 - Institucioni harton raportin financiar që përmban një pasqyrë të detajuar financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare; Këto informacione janë të reflektuara për të gjitha vitet e tjera.</p> <p>Kriteri 3 - Lidhur me qëndrueshmërinë financiare të institucionit, vihet re që përgjatë viteve të zbatimit të programit BSc në Shkenca Juridike, por edhe gjatë periudhave të mëparshme, pagesat janë kryer në kohë dhe përvec burimeve financiare nga tarifat e studentëve, IAL 'AU' ka investuar në infrastrukturë, që lidhet edhe me kryerjen e shpenzimeve operationale. Përshtatja e ambienteve dhe investimet në salla, bibliotekë dhe pajisje IT në funksion të mësimdhënies krijojnë gjithashtu premisa për një zhvillim të qëndrueshëm edhe financiar të institucionit.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Programi i studimit mbështetet kryesisht në të ardhurat e krijuara nga pagesat e studentëve. Veprimtaria e tij ekonomike reflektohet në bilancet financiare të hartuara kërkesave ligjore tatimore. Institucioni realizon periodikisht auditim të brendshëm të fondeve dhe shpenzimeve të kryera, të cilat mundësojnë analizimin e plotë të situatës ekonomiko-financiare dhe shpërndarjen/alokimin e fondeve në mënyrë efçente.</p>	

Institucioni ka burime njerëzore dhe kapacitete menaxhuese të përshtatshme, të mjaftueshme dhe ka një koordinim të mirë të punës për një shpenzim më eficient të fondeve për programin BSc në Shkenca Juridike. Në pasqyrat financiare rezultojnë që më tepër se 65 % e të ardhurave nga tarifat e shkollimit (*shpenzohet për paga, honorare, veprimtari shkencore dhe fond ekselence*) shkon për studentin.

Institucioni ka reflektuar qëndrueshmërinë financiare, ka investuar në infrastrukturë dhe ka kryer investime për të krijuar asete të qëndrueshme materiale dhe njerëzore për të përthithur më shumë studentë vitet e ardhshme.

Institucioni i plotëson standardet lidhur me çështjet e financimit, raportimit financiar, auditimit dhe ofron qëndrueshmëri financiare dhe institucionale.

Sugjerim - Në hartimin e RVB në vijim do të sugjerohej që të dhënat financiare të paraqiteshin të plota sipas elementëve/komponentëve të përcaktuar tek rubrika 'Tregues të matshëm'.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Institucioni ka krijuar një njësi të posaçme në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor, që siguron drejtimin, këshillimin dhe mbështetjen për hartimin dhe zbatimin e procedurave të brendshme të sigurimit të cilësisë, që është Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë / ZSBC. Rregullat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe mënyra e funksionimit të ZSBC parashikohen nga Statuti i IAL 'AU'². Sigurimi i cilësisë në IAL 'AU', përfshirë këtu edhe programin e studimit BSc në Shkenca Juridike parashikohet në mënyrë të detajuar nga Kreu VII i Rregullores së IAL 'AU' (*Nenet 65-67*), si edhe nga Rregullorja e Fakultetit dhe Rregullorja e Departamentit të Shkencave Juridike.

Sipas Nenit 11/2 të Statutit të Universitetit, ZSBC është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të IAL dhe raporton periodikisht në lidhje me detyrat/veprimtarinë e kryer. ZSBC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë të programeve të studimit, dhe vlerësimit të brendshëm të institucionit, nëpërmjet analizave statistikore të të dhënave, të dhënave të evidentuara në regjistrat e IAL dhe Programit të studimit, sondazheve, pyetësorëve dhe intervistave me stafin akademik, stafin jo-akademik dhe studentët. Për këto të dhëna, ZSBC harton një raport vjetor ku përfshihen informacionet/vlerësimet në lidhje me procesin mësimor dhe jep rekomandime për përmirësimin e tij. Raporti vjetor i ZSBC i paraqitet fillimisht Rektorit dhe më pas Senatit Akademik dhe njësitëve të tjera të Fakulteteve, Departamenteve dhe pedagogëve. Këto organe (rast pas rasti) kanë marrë vendime për përmirësimin e atyre aspekteve të procesit mësimor që studentët kanë evidentuar apo që kërkojnë përmirësim, përshtatje, apo edhe përfshirje të risive të çështjeve ligjore.

ZSBC bashkëpunon dhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës dhe pedagogët apo Departamentet, për të përmirësuar vazhdimisht programet mësimore.

ZSBC funksionon edhe në nivel njësie bazë, pra Departamenti, kryesisht për çështjet e përmirësimit të kurrikulave, ndaj asistohet intensivisht nga Zyra e Kurrikulave, përpara fillimit të çdo viti të ri akademik, përgjatë procesit të mësimdhënies, ashtu edhe në përfundim të tij, duke analizuar programet mësimore, literaturën dhe format e vlerësimit.

Kontrolli dhe vlerësimi i cilësisë bëhet në bazë të të dhënave statistikore të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, raporteve semestrale të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të departamenteve, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Të gjitha këto të dhëna statistikore vihen në dispozicion të ZSBC nga Departamenti & sekretaria mësimore. Pedagogët e programit të studimit BSc në Shkenca Juridike janë njohur me të dhënat/vlerësimet e pyetësorëve si dhe me komentet që studentët kanë bërë për secilin pedagog. Nga takimi që grupi i vlerësimit të jashtëm pati me stafin akademik (PAE & PAK), mësuam se disa nga pedagogët kishin reflektuar mbi ato komente të studentëve që ata i konsideronin të arsyeshme.

Lidhur me Treguesit e matshëm, ato rezultuan të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga RVB

² <http://albanianuniversity.edu.al/ep-content/uploads/2017/03/Statuti-i-AU-i-riorganizuar-sipas-ligjit-80.15-2.pdf>

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>Kriteri 1 - Departamenti përdor kryesisht metodat e vlerësimit sasior dhe cilësor në vlerësimin e ecurisë së programit BSc në Shkenca Juridike - sasior lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga pedagogët dhe studentët dhe cilësor pasi analizon proceset e mësim-dhënies/mësim-nxënies, analizon praktikat e ndjekura në vlerësim, përmirëson komunikimin student-pedagog, etj.</p> <p>Departamenti përdor <u>anketimet tek studentët</u> si një instrument për vlerësimin e programeve të studimit. Këto anketime në formën e formularëve për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative lidhen me :</p> <ul style="list-style-type: none"> - metodat e mesimdhënies që përdor pedagogu. - integrimin e kërkimit shkencor me mesimdhënien. - qartësia e gjuhës së pedagogut. - sjellja etika e tij në auditor dhe jashtë auditorit. <p>Kriteri 2 - Departamenti e ka përfshirë të gjithë këtë informacion në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe kjo reflektohet si në RVB ashtu edhe në procesverbalet e mbledhjeve që stafi akademik dhe ai administrativ, përfshirë edhe studentët kanë realizuar me qëllimin diskutimin e praktikave të vlerësimit të cilësisë dhe reflektimit/pasqyrimin të tyre nga ana sasiore dhe cilësore.</p> <p>Kriteri 3 - Departamenti ka miratuar jo vetëm strategjinë e rritjes së cilësisë, por për çdo proces që përfshihet vlerësimi i cilësisë dhe rritja e saj ka miratuar aktet përkatëse (siç reflektohet te pjesa përshkruese <i>supra</i>). Në rang IAL, institucioni ka miratuar edhe Strategjinë e Zhvillimit Institucional, ku rrija e vazhdueshme e cilësisë është një nga sfidat kryesore dhe misioni i IAL 'AU' (http://albanianuniversity.edu.al/sq/strategjia-e-zhvillimit-institucional/)</p> <p>Kriteri 4 - Institucioni dhe Departamenti i Shkencave Juridike, për të matur dhe vlerësuar cilësinë, përdor kryesisht metoda dhe teknika të tërthorta të marrjes së informacionit (siç reflektohet te pjesa përshkruese <i>supra</i>) kryesisht pyetësorë të studentëve dhe pedagogëve, takime ndërmjet tyre, intervista, etj.</p> <p>Këto vlerësime plotësohen edhe nga marrja e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë kryesisht nga vizitat në leksione dhe seminare, ndjekja e praktikave mësimore, vlerësimet paraprake të pjeshme në kolegiume, detyrat e kursit, gjyqe të simuluar (imituese) etj.</p> <p>Në përfundim të të gjithë këtyre komponentëve të vlerësimit të cilësisë, hartohet një Raport i cili i vihet në dispozicion autoriteteve drejtuese dhe diskutohet në mbledhje të posaçme.</p>

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Kriteri 1 - Nga vizita në institucion, u informuam se Albanian University është në proces akreditimi institucional nga Agjensia Britanike e Vlerësimit QAA.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është akredituar në vitin 2010.

Kriteri 2 - Institucioni përdor të gjitha instrumentet e përshtatshme për sigurimin e cilësisë në mësim-dhënie dhe mësim-nxënie, të cilat monitorohen në zbatimin e tyre nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (*siç reflektohet te pjesa përshkruese supra*)

Institucioni përdor si udhëzues Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së bashku me standardet, miratuar nga APAAL; ai kryen në mënyrë sistematike vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të tërthorta, si sondazhet apo organizimit të pyetësorëve në internet me të gjithë studentët.

Institucioni i ka kushtuar rëndësi edhe kërkimit shkencor duke krijuar kushte për botime në revistën 'Optime' e cila është pajisur me numër ISSN, ka Bordin e saj Shkencor dhe botohet periodikisht. Vihet re që botimet në revistë janë kryesisht të stafit akademik të Fakultetit Shkencave Shoqërore dhe të Fakulteteve të tjera të IAL 'AU' në një larmishmëri tematikash - mund të sugjerohet që për të trajtuar çështje të një rëndësie të madhe apo të aktualitetit, Bordi Shkencor të caktojë herë pas here tema apo problematika ligjore që të mund të trajtohen jo vetëm nga stafi akademik i Fakultetit por kryesisht nga ekspertë të fushës për të rritur cilësinë e debatit juridik.

Kriteri 3 - IAL, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike ka një politikë të qartë lidhur me efikasitetin e veprimtarive që kryen dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë të programit BSc në Shkenca Juridike. Ai ndjek procedurën e vlerësimit periodik nëpërmjet pyetësorëve (*për studentët dhe pedagogët*), kontrolleve periodike të paracaktuara ndaj pedagogëve përgjatë leksioneve dhe seminareve, përgjatë praktikës mësimore si dhe nëpërmjet analizës/relacionit individual që çdo pedagog harton në përfundim të modulit që zhvillon.

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme (*periodik*) të programit BSc në Shkenca Juridike - kjo realizohet nëpërmjet pyetësorëve, relacioneve, monitorimeve, kontrolleve, intervistave, takimeve, etj.

Kriteri 5 Institucioni ka qëllim dhe praktikë pune ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programin BSc në Shkenca Juridike lidhur me sigurimin e cilësisë. Kjo proklamohet edhe në Misionin e institucionit edhe në të gjitha aktet e miratuara për ecurinë e programit dhe sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë. Institucioni ka marrë të gjitha masat formale dhe

konkrete për matjen e cilësisë dhe përmirësimin e saj.

Institucioni ka hartuar edhe një set dokumentacioni informues dhe edukues për studentët - në faqen e internetit atyre u dedikohet një rubrikë e vecantë (<http://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/>) Materialet informuese për ta janë në trajtën e Manualeve, të cilat shpërndahen në fillim të vitit akademik por edhe përgjatë tij kryesisht nga sekretaria mësimore dhe Zyra e Kurrikulave.

Për studentët janë zhvilluar leksione të hapura dhe debate për të reflektuar një qasje të re të mësim-dhënies sic aplikohet në institucionet e huaja, janë zhvilluar konferenca shkencore; studentët janë organizuar në klube studentore në supervizionin e pedagogëve, në funksion të rritjes së cilësisë dhe nxitjes së aftësive praktike.

Kriteri 6 - Institucioni ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit Institucional. Ndërkohë që çdo vit akademik hartohet edhe plani i punës i ZSBC me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Këto informacione reflektohen të përmbledhura në faqen e internetit të IAL 'AU'. Nga takimi me studentët, pedagogët dhe anëtarët e ZSBC u informuam se kryesisht çështjet e cilësisë së mësim-dhënies dhe komunikimi me studentët janë objekt diskutimi të vazhdueshëm (*jo-formalisht*) dhe periodik (*formalisht në përfundim të semestrit kur hartohen raportet apo plotësohen pyetësorët*).

Konkluzione të GVJ:

Programi BSc në Shkenca Juridike ka plotësuar standardet institucionale dhe është në pritje të fillimit të procedurave të akreditimit institucional me agjensinë britanike të vlerësimit QAA, ndërkohë Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka marrë akreditim institucional që nga viti 2010.

Institucioni ka ngritur të gjithë infrastrukturën e përshtatshme dhe përdor me efektivitet instrumentet për sigurimin e cilësisë në mësim-dhënie dhe mësim-nxënie, të cilat monitorohen nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Institucioni kryen në mënyrë sistematike vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të tërthorta, si sondazhet apo organizimit të pyetësorëve në internet me të gjithë studentët. Institucioni i ka kushtuar rëndësi edhe kërkimit shkencor duke krijuar kushte për botime në revistën 'Optime' e cila botohet periodikisht.

Institucioni ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit Institucional. Ndërkohë që çdo vit akademik hartohet edhe plani i punës për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Cilësia e mësim-dhënies dhe komunikimi me studentët janë objekt diskutimi të vazhdueshëm dhe periodik. IAL, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike ndjek një politikë të qartë lidhur me efikasitetin e veprimtarive që kryen dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë të programit BSc në Shkenca Juridike. Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme (*periodik*) të programit BSc në Shkenca Juridike - kjo realizohet nëpërmjet pyetësorëve, relacioneve, monitorimeve, kontrolleve, intervistave, takimeve, etj.

Institucioni ka qëllim dhe praktikë pune ndërjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programin BSc në Shkenca Juridike lidhur me sigurimin e cilësisë.

Institucioni ka hartuar një set dokumentacioni informues dhe edukues për studentët që aksesohet lehtësisht në faqen e internetit të IAL 'AU'. Institucioni ka zhvilluar leksione të hapura dhe debate për të reflektuar një qasje të re të mësim-dhënies, ka zhvilluar konferenca shkencore; studentët janë organizuar në klube studentore në funksion të rritjes së cilësisë dhe nxitjes së aftësive praktike.

Në konkluzion, mund të thuhet se Institucioni ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për miratimin e akteve formale për sigurimin e cilësisë dhe disponon të dhëna të plota lidhur me programin. Institucioni përdor mekanizma të ndryshëm duke i ndërthurrur për vlerësimin e cilësisë dhe adresimin e nevojave për përmirësimin e situatës.

Nga vizita në institucion si dhe konsultimi i dokumentacionit të kërkuar lidhur me të dhëna sasiore për vlerësimin e cilësisë, rezultoi përputhshmëri e plotë e të dhënave të reflektuara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm - standardet për sigurimin e cilësisë në institucion janë plotësuar plotësisht.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi i Studimit BSc në Shkenca juridike rezultoi të jetë hartuar në përputhje me legjislacionin e mëparshëm për për Arsimin e Lartë (ligji nr. 9741, datë 21.5.2007), me Udhëzimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës Nr. 15, datë 04.04.2008 'Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë', Udhëzimin Nr.11, datë 28.02.2011 'Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë, Programeve të reja të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimit jo universitare, të natyrës profesionale dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës' si dhe me Statutin dhe Rregulloren e Institucionit.

Programet e lëndëve i janë nënshtruar në vazhdimësi përmirësimit të tyre për çdo semestër nga stafi akademik dhe kanë qëllim përgatitjen e përgjithshme të studentëve, pasi përmbajnë lëndë të formimit bazë duke përfshirë module të së drejtës private, publike dhe penale, si dhe lëndë më specifike apo të profilizuara. Programet e lëndëve reflektuan komponentë që lidhen me formimin teorik të studentëve ashtu edhe atë të zbatimit praktik.

Nga vizita në institucion, inspektimi i dokumentacionit të shkruar dhe miratuar lidhur me programin mësimor, treguesit e matshëm rezultuan të njëjtë me ato të paraqitura në mënyrë të detajuar në RVB sipas tabelave përkatëse.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi
- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
 - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë
- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
 - Për leksionet 10-12 orë në auditor dhe 13-15 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Seminaret 8 orë në auditor dhe 17 orë punë e pavarur e studentit
 - Për Laboratoret Nuk ka orë të tilla
 - Për Praktikat lëndore Nuk ka orë të tilla
 - Për Praktikën Profesionale 20 orë në institucione dhe 5 orë punë e pavarur e studentit
 - Provimi përfundimtar 2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Planet mësimore janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk kanë pësuar ndryshime jashtë kufijve të përcaktuar nga ligji. Në këtë rast të dhenat përputhen plotësisht me RVB, sipas tabelave përkatëse.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Nga të dhenat në RVB (tabela nr.13), si edhe nga krahasimi me dokumentin e marrë në njësinë e burimeve njerëzore titulluar "lista titullare pedagogë", u vërejt një mospërputhje.

Duke qenë se në RVB deklarohet se titullarët e lëndëve janë të gjithë të pedagogë të kategorisë “profesorë”, atëherë në plotësimin e të dhenave përkatëse u morr në konsideratë dokumenti titulluar “lista titullarë pedagogë”, e cila pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Lënda/moduli	Pedagogu përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Statusi PAE apo PAK
1.	E drejtë publike	Ervin Karamuço	Prof.Asoc.Dr.	PAK
2.	E drejte romake	Juliana Latifi	Prof.Dr.	PAK ³
3.	Histori e institucioneve	Ervin Karamuço	Prof.Asoc.Dr.	PAK
4.	E drejte civile (pj e pergjithshme I)	Eriona Katro	Prof.Dr.	PAK
5.	Gjuhë e huaj (anglisht)	Afrim Karagjozi	Prof.Dr.	PAK ⁴
6.	Hyrje ne ekonomi	Elida Liko	Prof.Asoc.Dr.	PAK
7.	E drejtë kushtetuese	Ervin Karamuço	Prof.Asoc.Dr.	PAK
8.	E drejte civile (pj e pergjithshme II)	Eriona Katro	Prof.Dr.	PAK
9.	Psikologji gjyqësore	Fatmir Tartale	Prof.Asoc.Dr.	PAE
10.	Barazi gjinore dhe ligji	Ervin Karamuço	Prof.Asoc.Dr.	PAK
11.	Shkrim dhe arsytim ligjor	Ervin Karamuço	Prof.Asoc.Dr.	PAK
12.	Shkrim akademik	Merita Xhumari	Prof.Asoc.Dr.	PAK ⁵
13.	Filozofi e së drejtës	Eriona Katro	Prof.Dr.	PAK
14.	Informatikë juridike	Arjana Bejleri	Prof.Asoc.Dr.	PAK ⁶
15.	E drejtë penale	Fatmir Tartale	Prof.Asoc.Dr.	PAE
16.	E drejte familjare	Eriona Katro	Prof.Dr.	PAK
17.	E drejtë e punës dhe e sigurimeve	Eriona Katro	Prof.Dr.	PAK
18.	Anglishte juridike	Afrim Karagjozi	Prof.Dr.	PAK ⁷
19.	E drejte administrative	Ervin Karamuço	Prof.Asoc.Dr.	PAK
20.	E drejte e detyrimeve	Kestrin Katro	Prof.Dr.	PAK
21.	Procedure penale	Fatmir Tartale	Prof.Asoc.Dr.	PAE
22.	Procedure civile	Eriona Katro	Prof.Dr.	PAK
23.	E drejte tregtare	Argita Maltezi	Prof.Dr.	PAK
24.	E drejtë ndërkombëtare publike	Ervin Karamuço	Prof.Asoc.Dr.	PAK
25.	E drejtë ndërkombetare private	Eriona Katro	Prof.Dr.	PAK
26.	E drejte e bashkimit europian	Eriona Katro	Prof.Dr.	PAK
27.	Te drejtat e njeriut	Ervin Karamuço	Prof.Asoc.Dr.	PAK
29.	Kriminologji – penologji	Ervin Karamuço	Prof.Asoc.Dr.	PAK
30.	Praktika Gjyqësore	Fatmir Tartale	Prof.Asoc.Dr.	PAE

Përsa i përket anëtarëve të stafit akademik të përfshirë në këtë program, sipas dokumentit të titulluar “Profili i pedagogut, lendet dhe ngarkesa per prog.st..pdf”, rezulton se në programin BSc në Shkenca juridike, janë aktivizuar 14 pedagogë, anëtarë të personalit akademik efektiv, dhe 11 pedagogë, anëtarë të personalit akademik me kontratë. Me e detajuar kjo tabelë jepet më poshtë:

Për programin e studimit BSc në shkenca juridike	
PAE	PAK
1. Renata Tokrri	1. Erjona Katro
2. Vilma Hasneziri	2. Erjena Bashari
3. Eva Babameto	3. Anila Agalliu
4. Jonida Skëndaj	4. Entiola Pano
5. Pjereta Agalliu	5. Fjoralba Zeko

³ Nuk rezulton e deklaruar në tabelën nr.3, faqe 18-19 të RVB

⁴ Nuk rezulton i deklaruar në tabelën nr.3, faqe 18-19 të RVB

⁵ Nuk rezulton e deklaruar në tabelën nr.3, faqe 18-19 të RVB

⁶ Nuk rezulton e deklaruar në tabelën nr.3, faqe 18-19 të RVB

⁷ Nuk rezulton i deklaruar në tabelën nr.3, faqe 18-19 të RVB

6. Ismail Tafani	6. Ervin Karamuço
7. Julian Çota	7. Enkeleda Mandri
8. Elona Doko	8. Elida Liko
9. Melisa Male	9. Kestrin Katro
10. Dhurata Islambejo	10. Medion Hysenaj
11. Diana Skrapari	11. Argita Malltezi
12. Brikena Kasmir	
13. Migena Haznedari	
14. Fatmir Tartale	

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

Në bazë të Rregullores së programit të studimit të Ciklit të Parë BSc në Shkenca juridike afati i studimeve për programin e ciklit të parë është 3 vjet dhe është i organizuari në 6 semestra, me 180 kredite në total (60 kredite çdo vit akademik). Viti akademik ka 30 javë mësimore në auditor dhe semestri ka 15 javë mësimore në auditor. Ndërkohë që 1 Kredit (ECTS) është i barabartë me 25 orë mësimore punë të studentit (ku 1 orë mësimore zhvillohet në 60 minuta). Planet mësimore paraqesin ndarjen e ECTS sipas komponentëve dhe formave të mësimdhënies për çdo lëndë/modul. Kurrikula e programit të studimit, kreditet dhe veprimtaritë e tjera formuese janë të organizuara në komponentët e:

- Moduleve të formimit të përgjithshëm
- Moduleve të formimit karakterizues të programit
- Moduleve formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese
- Moduleve formuese të zgjedhura nga studentët ndërmjet atyre që ofron institucioni
- Veprimtari formuese, gjuhë e huaj, praktikë apo stazhe
- Përgatitja e tezës së diplomës - Emërtimi i Diplomës për çdo programi studimi është Bsc në Shkenca juridike.

Plani mësimor për të gjitha vitet e studimit të programit të ciklit të parë BSc në Shkenca juridike rezultoi i organizuar dhe i kryes sipas parashikimeve. Plani mësimor ka pësuar ndryshime të herëpashershme, të cilat nuk e kalojnë limitin e përcaktuar nga Ligji (jo më shumë se 20 % e programit).

Nga vizita në institucion, inspektimi i dokumentacionit të shkruar dhe miratuar lidhur me ndryshimet e programit mësimor, treguesit e matshëm rezultuan të njëjtë me ato të paraqitura në mënyrë të detajuar në RVB.

Syllabuset e çdo lënde/moduli ishin hartuar të plota dhe përmbanin të gjithë elementët e kërkuar në RVB, përfshirë edhe literaturën bazë (të detyrueshme) dhe atë ndihmëse. Nga shqyrtimi i tabelave të pedagogëve që japin mësim në ciklin e parë të studimeve BSc në Shkenca juridike u vu re që disa pedagogë jepnin lëndë/module të cilët nuk janë shumë të lidhur me njëri tjetrin përse i përket fushës të së drejtës. Ndoshta në të ardhme mund të shikohet mundësia që një pedagog të mund të japë mësim në lëndë/module ku ka fushën e tij/saj të ekspertizës ose edhe lëndë të tjera të ngjashme.

Lidhur me ndryshimet që do të realizohen në kuadrin e programeve të reja të studimit sipas Ligjit 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH', është e këshillueshme ngritja e një "Klinike ligjore" Për ta bërë funksionale dhe të vlefshme për këshillohet të shikohet mundësia për të krijuar një modul/lëndë të re 'Klinika Ligjore' e cila fillimisht mund të përshihet si lëndë me zgjedhje e më pas nëse gjykohet e arsyeshme dhe e dobishme mund të kalojë edhe si lëndë e detyrueshme - kjo për të aftësuar studentët për të dhënë asistencë ligjore *pro bono* në raste konkrete si dhe për t'i aftësuar ata për tregun e punës, nëpërmjet vetë Klinikës ligjore që mund të krijohet në institucion.

Në RVB deklarohet se nga Albanian University në fushën e shkencave juridike, diplomohen edhe personat të aftë për të punuar si nëpunës të policisë së shtetit. Kjo pjesë duhet rregulluar pasi me miratimin e ligjit të ri të policisë së shtetit (nr.108/2014), nëpunësit në këtë strukturë duhet që të përfundojnë studimet në Akademinë e Policisë.

Një tjetër sugjerim do të shihte edhe realizimi i një studimi tregu përse i përket kërkesave që ka ky i fundit në lidhje me profilin e studentëve që mbarojnë studimet në fushën e shkencave juridike. Kjo do të mundësonte orientimin më të mirë të institucionit në hartimin dhe rishikimin e programeve të lëndëve në këtë fushë.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se një pedagog jep mësim në më shumë se një lëndë, ku të cilat shpesh herë i përkasin edhe fushave që janë shumë të ndryshme nga njëra tjetra. Sugjerojmë që në të ardhmen të shihet mundësia që një pedagog të japë mësim në një lëndë apo grup lëndësh të ngjashme.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Kriteri 1 – Institucioni ofron Programin BSc në Shkenca juridike, akredituar me Urdhër të MAS nr. nr.355, datë 3.11.2009, i ndryshuar me urdhërin nr.541, datë 1.12.2010, për prgramin e studimit në Shkenca juridike me afat 4 vjeçar. sipas shkresës nr.5695/1, datë 21.11.2012, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, akreditimi që i është bërë programi 4 vjeçar të studimit është konsideruar i vlefshëm edhe për programin 3 vjeçar Bsc në "Shkenca juridike".</p> <p>Kriteri 2 - Kreditet që përfiton një student gjatë një viti akademik me kohë të plotë janë sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), 60 ECTS.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p>	<p>Kriteri 1 & 2 - Departamenti i Shkencave Juridike dhe Sekretaria mësimore përgjegjëse për programin e studimi të ciklit të parë BSc në Shkenca juridike, i japin studentëve informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve. Pëveç kësaj, studentët informohen edhe nga pedagogët përgjegjës për secilën lëndë. Kjo procedurë zhvillohet si për lëndët (modulet) e detyrueshme ashtu edhe për lëndët me zgjedhje.</p> <p>Kriteri 3 & 4 - Departamenti, sekretaria mësimore dhe pedagogët u japin informacion studentëve për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e lëndës apo edhe</p>

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

të programit BSc në përgjithësi. Ato japin informacion edhe për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo detyrat e kursit, esetë, etj

Konkluzionet e GVJ:

Programi i Studimit BSc në Shkenca juridike rezultoi të jetë hartuar në përputhje me kriteret dhe standardet ligjore (të parashikuara nga Ligji 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', dhe Udhëzimet përkatëse). Për këtë qëllim Institucioni ka miratuar edhe Statutin dhe Rregulloren e Institucionit.

Programet e lëndëve i janë nënshtruar në vazhdimësi përmirësimit të tyre për çdo semestër nga stafi akademik dhe reflektuan komponentë që lidhen me formimin teorik të studentëve ashtu edhe atë të zbatimit praktik. Treguesit e matshëm rezultuan të njëjtë me ato të paraqitura në mënyrë të detajuar në RVB. Syllabuset e çdo lënde/moduli ishin hartuar të plota dhe përmbanin të gjithë elementët e kërkuar në RVB.

Standardët plotësohen kryesisht.

Sugjerime - Lidhur me ndryshimet që do të realizohen në kuadrin e programeve të reja të studimit - mund të shikohet mundësia për të krijuar një modul/lëndë të re 'Klinika Ligjore' për të fuqizuar edhe rolin e organizatës së krijuar për këtë qëllim.

Të rishikohen programet në përputhje me kërkesat e ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", me qëllim realizimin e një programi studimi 5 vjeçar në fushën e Shkencave juridike

Në të ardhmen mund të shikohet edhe mundësia që një pedagog të mund të japë mësim në lëndë/module ku ka fushën e tij/saj të ekspertizës ose edhe lëndë tjera të ngjashme.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkimore

Procesi i mësimdhënies në programin e studimit BSc në Shkenca Juridike në IAL 'AU' është rregulluar nga 'Rregullorja e Përgjithshme e Studimeve'⁸ (miratuar me Vendimin e Senatit të IAL 'AU' 22.12.2016). Duke qënë program bazë studimi BSc në Shkenca Juridike, mësimdhënia realizohet në formën klasike nëpërmjet **leksioneve dhe seminareve**, megjithatë nga takimi me studentët e programit si dhe nga pedagogët, dhe bazuar edhe në aktet e miratuara për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe sigurimin e cilësisë, u informuam se teknikat klasike të mësimdhënies pasurohen me **teknika të reja**, të cilat janë më të përshtatshme edhe për moshën e studentëve dhe formimin e tyre si detyra kursi, raste apo casuse praktike për zgjidhje, diskutime në klasë për çështje ligjore si edhe improvizime/simulime të procesit gjyqësor. Qëllimi kryesor i këtyre teknikave është nxitja e mendimit kritik tek studentët, aftësimi i tyre në raste konkrete/praktike si dhe zhvillimi i aftësive komunikuese, punës në grup, debatit, profesionalizmit, pavarësisë në zhvillimin e ideve dhe paraqitjes së tyre, etj. Pedagogët përgjatë modulit aplikojnë edhe teknika të vlerësimit të ndërmjetëm dhe me komponentë, në mënyrë që vlerësimi përfundimtar për modulin të jetë real, të pasqyrojë të gjithë elementët e temave të trajtuara dhe të zbulojë e vlerësojë në spekter të gjerë formimin e studentëve.

Lidhur me **procesin e mësimdhënies**, konstatoam se ai plotëson standardet formale të parashikuara në 'Rregulloren e Përgjithshme të Studimeve'; gjithashtu nga verifikimi në vend i regjistrave mësimorë dhe takimet e zhvilluara me studentët dhe pedagogët rezultoi se procesi mësimor është zhvilluar sipas programit dhe orarit të miratuar. **Orari mësimor** ka rezultuar i shpallur për studentët në ambientet e IAL dhe nëpërmjet komunikimit elektronik. Nga monitorimi i faqes së internetit të IAL 'AU', rezultoi që orari i studimeve të jetë ofruar edhe online⁹ për një akses sa më të lehtë të studentëve.

⁸ <http://albanianuniversity.edu.al/ep-content/uploads/2017/03/Rregullore-e-AU-riorganizuar-sipas-ligjit-80.15.pdf>

⁹ <http://albanianuniversity.edu.al/sq/kalendari-akademik/>

Për t'u njohur me institucionet dhe punën në to, si dhe për të njohur studentët me tregun e punës, institucioni ka nënshkruar **marrëveshje me institucione** shtetërore dhe private që studentët të kryejnë praktikën mësimore. **Praktika mësimore** kryhet në drejtimin e një pedagogu udheheqës/drejtuës i cili orienton studentët dhe udhëzon ata për të përgatitur një relacion të punës në institucion. Praktika mësimore është një komponent që vlerësohet me kredite si edhe lëndët e tjera.

Në përfundim të moduleve të parashikuara nga programi mësimor, studenti ka mundësi të përfundojë studimet e tij me hartimin e **punimit të diplomës** - Institucioni për këtë qëllim ka miratuar edhe 'Manualin për punimin e temës së diplomës'¹⁰. Në përfundim të studimeve, studenti duhet të marrë 180 kredite në mënyrë që studimet në programin BSc në Shkenca Juridike të konsiderohen të kryera.

Nga vizita në institucion dhe nga takimet me studentët dhe pedagogët, konstatuam se IAL ndjek një politikë mjaft aktive për **informimin e studentëve** në cdo fazë të studimeve të tyre. Informacioni fillestar për programin e studimit fillon që në momentin kur ata janë nxënës të shkollave të mesme, vijon me vizitat informuese në ambientet e IAL 'AU', me reklamimin e tyre në TV e universitetit, dhe vazhdon përgjatë gjithë kohës që studenti është pjesë e programit, deri në përfundimin e tij. Këtu mund të permendet përgatitja e Manualit të Studentëve¹¹, Udhëzuesit të Karrierës¹² dhe Manifestit Akademik¹³.

Gjithashtu u konstatua një tendencë e perfshirjes së studentëve në aktivitete debati si dhe në kërkimin shkencor, duke i bërë pjesë e diskutimeve dhe prezantimeve. Gjithashtu studentët nga ana e tyre na informuan se periodikisht mblidhen për të diskutuar në klube studentore nën drejtimin apo udheheqjen e një pedagogu efektiv, i cili moderon debatin, orienton studentët për të kryer kërkime ligjore dhe koordinon pjesëmarrjen e tyre.

Lidhur me procesin e **transferimit të studentëve** dhe ekuivalentimin e lëndëve, Rregullorja e Përgjithshme e Studimeve të IAL 'AU' ka parashikuar kritere të posacme. Procesi i ekuivalentimit kryhet nga departamentet dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore; për këtë qëllim ngrihet një komision me vendim të Rektorit. Kërkesa e studentit për transferimin e studimeve së bashku me listën e notave dhe syllabuset e lëndëve depozitohen në sekretarinë mësimore. Dokumentacioni i plotë i përcillet Dekanit të Fakultetit dhe më pas komisionit të ekuivalentimit pranë departamenteve, i cili bën vlerësimin e lëndëve sipas planeve dhe programeve mësimore të programit BSc në Shkenca Juridike, transferimin e krediteve dhe të vlerësimeve si dhe bën propozimin për regjistrimin e studentit në vitin ku duhet të vijojë aplikanti dhe detyrimet plotësuese që ai duhet të shlyejë.

Kontrolli i njohurive të studentëve bazohet në disa komponentë kryesorë:

- **Testimin e ndërmjetëm**; nga vizita në IAL u informuam se studenti testohet të paktën tri herë gjatë semestrit në secilën lëndë, pra në mënyrë dinamike përmes provimeve të pjesshme, detyrave të kursit, aktivizimit gjatë orëve të seminareve dhe vlerësimit të tij, si dhe pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor;

- **Testimin përfundimtar**;

- **Pjesëmarrjen aktive në seminare** dhe

- **Esse/Prezantim/punë në grup**

Këto komponentë duke u alternuar plotësojnë tablonë e vlerësimit dhe bëjnë atë objektive dhe reale.

Sallat e leksioneve përveç projektorëve, ofronin edhe një akustikë mjaft të përshtatshme për mësimdhënien pasi zëri/e folura arrinte të mbulonte të gjithë sallën me kapacitet të plotë. Gjithashtu, sallat e leksioneve dhe të seminareve ishin organizuar në mënyrë komode dhe të përshtatshme për t'i krijuar nga njëra anë pedagogut një pozicion drejtues përgjatë procesit si dhe fleksibilitet për të lëvizur nëpër sallë kur kërkohet të ndërveprojë me studentët, dhe për më tepër për të krijuar edhe një ambient komod për studentin qoftë nga pikëpamja akustike, edhe nga pikëpamja fizike (*banka/tavolina*).

Si konkluzion i përgjithshëm mund të thuhet se gjendja e verifikuar në institucion përputhet plotësisht me të dhënat e deklaruara në RVB të hartuar nga institucioni.

¹⁰ <http://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-per-punimin-e-temes-se-dipolmes/>

¹¹ <http://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-i-studenteve/>

¹² <http://albanianuniversity.edu.al/sq/udhezuesi-i-karrieres/>

¹³ <http://albanianuniversity.edu.al/sq/manifesti-akademik/>

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Pranimi në ciklin e parë të studimeve BSc në Shkenca Juridike është kryer bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë'; Ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi të nxjerra nga MAS.

Në programin e studimit BSc në Shkenca Juridike, për vitet 2010-2015 rezultojnë të regjistruar për herë të parë nga 438 studentë, me një notë mesatare në hyrje rreth 6.65, ndërkohë që janë diplomuar 213 studentë për vitet 2013-2015, me një notë mesatare 7.26. Për periudhën 2010-2016, janë diplomuar gjithsej 1018 studentë.

Nga dokumentacioni i kërkuar dhe i vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion, për vitin akademik 2016-2017 rezulton se janë transferuar nga Filiali i Beratit 236 studentë, pasi ky filial është pezulluar sipas Urdhërit Nr. 540 të MAS, datë 06.08.2014 **'Për pezullimin e vëmprimitarisë së disa Institucioneve Private të Arsimit të Lartë'**; këta studentë fillimisht nuk kanë pasur numër matrikullimi, por pas transferimit janë pajisur me numra matrikullimi nga Agjensia Kombëtare e Provimeve.

Për të njëjtin filial, rezultoi se studentët që kishin përfunduar studimet në ciklin e parë, në programin BSc në Shkenca Juridike, dhe kishin mbrojtur edhe diplomën, për shkak të mbylljes së tij dhe konstatimit me shkresën e MAS dt. 07.07.2016 'se AU nuk ka njësi kryesore në Berat që ka të drejtën të ofrojë programe studimi', nuk mund të procedohej me regjistrimin e diplomave - për këtë shkak studentët kanë ri-mbrojtur diplomat në AU, programi BSc në Shkenca Juridike, në Tiranë dhe më pas janë diplomuar.

Për periudhën 2010-2016, 153 të diplomuar (ose 15 % e numrit të përgjithshëm të të diplomuarve) rezultonin të punësuar në përputhje me diplomën e fituar, dhe 65 të diplomuar (ose 6.4 % e numrit të përgjithshëm të të diplomuarve) rezultomin të punësuar jo në përputhje me diplomën e fituar.

Dokumentet që ata duhen të paraqesin në momentin e pranimit janë Diploma e maturës shtetërore së bashku me çertifikatën e notave ose dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit (apo Dëftesën e pjekurisë së shkollës së mesme për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011), fotokopja e noterizuar e kartës së identitetit ose e letër njoftimit, 4 fotografi si dhe Formulari i aplikimit i plotësuar.

Mesatarja e notave në hyrje të studentëve në momentin e pranimit ndryshon nga viti në vit, (Shiko tabelën më poshtë) megjithatë vihet re një rritje e lehtë vitin e fundit akademik.

Nr. Rendor	Viti Akademik	Mesatarja në hyrje e studentëve
1	2010 - 2011	6.42
2	2011 - 2012	6.83
3	2012 - 2013	6.57
4	2013 - 2014	6.53
5	2014 - 2015	6.67
6	2015 - 2016	6.9

Studimet e Ciklit të Parë zgjasin gjashtë semestra dhe përfshijnë zhvillimin e leksioneve, seminareve, detyrat e kursit, praktikat mësimore, specializimet, kualifikimet, kërkimin shkencor dhe aktivitete të tjera akademike.

Studenti pranohet në provimin përfundimtar të lëndës/modulit nëse ka shlyer detyrimet akademike dhe ka frekuentuar rregullisht leksionet dhe seminarat (studenti nuk lejohet të zhvillojë provimin e një lënde nëse ka kryer më shumë se 25% të mungesave në seancat mësimore të asaj lënde; nëse ai ka kryer deri në 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës atëherë ai

pranohet në sesionin e dytë; nëse studenti ka kryer mbi 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës shpallet përsëritës në atë lëndë).

Lidhur me informacionin që marrin studentët e programit nga vizita në institucion dhe takimi me studentët dhe pedagogë u informuam se sekretaria mësimore dhe Departamenti/pedagogët janë në kontakt të vazhdueshëm me studentët, pasi ata informohen në vazhdimësi për kalendarin akademik, për periudhën e provimeve të pjesshme, për sesionet e provimeve, për çdo element që ka lidhje të drejtpërdrejtë me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Gjithashtu të gjitha këto informacione gjenden të plota dhe aksesohen lehtësisht edhe në faqen e internetit të IAL 'AU'. Studentët e diplomuar në programin e studimit BSc në Shkenca Juridike rezultojnë se janë të angazhuar me kohë të plotë ose të pjesshme si juristë në institucione të Administratës Publike, kompani private, agjensi biznesi, zyra avokatie, inspektorë, etj.

Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Këshillimit të Studentëve janë në kontakt me studentët e diplomuar në mënyrë që ata të kenë mundësi të informohen vazhdimisht lidhur me mundësitë akademike përtej studimeve të ciklit të parë, lidhur me aktivitetet profesionale si dhe me ecurinë e karrierës së tyre. Për këtë qëllim, këto njësi të 'AU' kanë ndërtuar një bazë të dhënash të studentëve në mënyrë që bashkëpunimi me studentët të vazhdojë edhe pas diplomimit të tyre. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Qendrës së Këshillimit dhe Zhvillimit të Karrierës. Orientimi dhe konsultimi për çështjet e zhvillimit profesional dhe karrierës u ofrohet studentëve nëpërmjet dy aktiviteteve kryesore - 'Ditëve të karrierës' dhe 'Panairit të punës' si dhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera ndihmëse për vazhdimësinë akademike dhe profesionale si takime, debate, vizita në institucione, etj.

Të dhënat sasiore u verifikuan gjatë vizitës në institucion dhe rezultuan të njëjta me ato të raportuara në RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Kriteri 1 - Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi të nxjerra nga MAS.</p> <p>Kriteri 2 - IAL 'AU' ka miratuar mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për student edhe për programin BSc në Shkenca Juridike, por nuk rezultojnë që të jenë miratuar kritere shtesë.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program</p>	<p>Kriteri 1 - Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit BSc në Shkenca Juridike si nga stafi akademik edhe ai administrativ i IAL 'AU'. Edhe faqja e internetit është një mundësi shumë e vlefshme për informimin e studentëve, nëpërmjet Manualeve që janë miratuar për këtë qëllim.</p> <p>Kriteri 2 - Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde/moduli në përfundim të çdo semestri nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të</p>

studimi.	<p>hartuar nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë në 'AU' i cili mbledh informacion mbi pedagogun e lëndës, mbi mënyrën dhe cilësinë e realizimit të lëndës mësimore.</p> <p>Kriteri 3 - Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Qendrës së Këshillimit dhe Zhvillimit të Karrierës. Orientimi dhe konsultimi për çështjet e zhvillimit profesional dhe karrierës u ofrohet studentëve nëpërmjet dy aktiviteteve kryesore - 'Ditëve të karrierës' dhe 'Panairit të punës' si dhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera ndihmëse për vazhdimësinë akademike dhe profesionale si takime, debate, vizita në institucione, etj.</p> <p>Kriteri 4 - Studentëve u jepet informacion i vazhdueshëm si nga stafi administrativ edhe ai akademik, përfshirë edhe Qendrën e Këshillimit dhe Zhvillimit të Karrierës lidhur me për akreditimin e institucionit, të programit të studimit, për procedurat e njohjes dhe vlefshmërisë së diplomave brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu studentët informohen edhe për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të programit, informacion për vazhdimin e studimeve në programe të ciklit të dytë Master apo edhe trajnime/formime profesionale.</p>
----------	--

Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Kriteri 1 - Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë të Programit BSc në Shkenca Juridike.</p> <p>Kriteri 2 - Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve, përfshitë këtu edhe transferimet nga IAL të tjera.</p> <p>Kriteri 3 - Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim, përfshirë këtu edhe të dhëna për punësimin e tyre bazuar në diplomën/formimin e marrë nga programi BSc në Shkenca Juridike.</p> <p>Të gjitha këto të dhëna përpunohen si nga institucioni (nëpërmjet Sekretarisë mësimore) dhe depozitohen çdo vit në Zyrën e Statistikave në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, sipas detyrimeve ligjore.</p>
--	---

Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Kriteri 1 - IAL 'AU' u ofron këshillim karriere studentëve nëpërmjet Qendrës së Këshillimit dhe Zhvillimit të Karrierës. Për një këshillim më të plotë, referuar edhe moshës së tyre dhe sfidave sociale, profesionale dhe fiziologjiko-mendore me të cilat ata përballen, IAL ka ngritur edhe Zyrëne Këshillimit Psikologjik.</p> <p>Kriteri 2 - IAL 'AU', nëpërmjet pedagogëve të departamentit të programit BSc në Shkenca Juridike dhe Qendrës së Këshillimit dhe Zhvillimit të Karrierës ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, kryesisht në Institucionet publike apo privatë si dhe me gjykata të Shkallës së Parë, me të cilat ai ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi ku është rënë dakord që studentët të zhvillojnë Praktikën Profesionale, nën drejtimin e pedagogut përgjegjës.</p> <p>Gjithashtu studentët informohen për cdo detaj lidhur me programet e studimit, procesin mësimor dhe zhvillimin profesional apo të karrierës edhe nëpërmjet faqes së internetit të IAL 'AU', fletëpalosjet, stafi akademik dhe administrativ si dhe nga media.</p>
<p><u>Konkluzionet e GVJ</u></p> <p>Studentët në programin e studimit BSc në Shkenca Juridike të IAL 'AU', u konstatua se pranohen në bazë të <u>kritereve dhe procedurave ligjore</u>, (Liqji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; liqjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi të nxjerra nga MAS). Institucioni ka miratuar edhe <u>mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për studente</u> me qëllim që të rrisë cilësinë e studentëve të pranuar në ciklin e parë të studimeve BSc në Shkenca juridike.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar në vitin e parë, të studentëve të diplomuar dhe atyre të transferuar, të dhëna të plota statistikore, dosjet e plotësuar për secilin student të transferuar/larguar si dhe të dhëna për numrin e të punësuarve në pëputhje ose jo me diplomën.</p> <p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit BSc në Shkenca Juridike si nga stafi akademik, ai administrativ i IAL 'AU' dhe nëpërmjet faqes së internetit. Ndërkohë përgjatë gjithë procesit mësimor pedagogët dhe zyrat e mbështetjes së studentëve në universitet, i orientojnë studentët, ndjekin ecurinë e tyre dhe japin këshillim për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor dhe praktikën. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Qendrës së Këshillimit dhe Zhvillimit të Karrierës, për mundësitë për punësim, për programet e ciklit të dytë Master dhe trajnime/formime profesionale.</p> <p><u>Në këtë kontekst, të gjitha standardet e përcaktuara plotësohen tërësisht.</u></p> <p>Sugjerojmë që në të ardhmen Institucioni të përcaktojë edhe kritere shtesë për pranimin e studentëve në rritje të cilësisë.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Për qëllime të organizimit të kërkimit shkencor, në nivel njësie kryesore është ngritur Qendra e Kërkimit Shkencor. Kjo njësi drejton dhe koordinon kërkimin shkencor për të gjitha zhvillimet në këtë fushë. Më konkretisht kjo njësi merret me organizimin e konferencave, leksioneve të hapura, seminareve, simpoziumeve, botimeve shkencore, pjesëmarrja në trajnime etj.

Në përgjithësi puna individuale e secilit prej anëtarëve të personelit akademik, publikohet në Revistën "Optime" e cila del rregullisht dy herë në vit. Për këtë Revistë nga ana e institucionit arsimor na është vënë në dispozicion Rregullorja përkatëse e cila është ngarkuar edhe në platformën elektronike ASCAL. Kjo Revistë funksionon me bord shkencor i cili është ngritur me vendim të Senatit Akademik, si edhe është e paisur me ISSN. Numri i saj më i fundit rezultoi se është publikuar në faqen e internetit të institucionit, por nuk rezultoi që të jetë publikuar numrat e tjerë, si edhe të paktën edhe tabela e përmbajtjes për secilin numër. Sugjerojmë që në këtë rast të bëhet publike edhe tabela e përmbajtjes me qëllim rritjen e interesit, jo vetëm për studentet e Institucionit, por edhe për persona të tjerë të cilët realizojnë kërkim shkencor.

Nga analiza në institucion rezultoi se nga ana tij nuk është fituar asnjë projekt në fushën e shkencave juridike.

Institucioni organizon rregullisht edhe Konferenca Shkencore me karakter Kombëtar dhe Ndërkombëtar. Një pjesë e këtyre Konferencave përmenden edhe në RVB. Kjo tregon për një jetë aktive akademike. Një pjesë e këtyre konferencave kanë shërbyer edhe për stafin akademik, me qëllim rritjen e kualifikimit të tyre akademik dhe plotësimin e kritereve për marrjen e gradave/titujve shkencorë. Po kështu në këto Konferenca kanë marrë pjesë dhe janë përfshirë edhe studentët të Institucionit të cilët kanë prezantuar materialet e tyre. Këto konferenca janë realizuar edhe në bashkëpunim me institucione të tjera të administratës publike, si edhe në disa raste edhe me institucione ndërkombëtare. Në faqen e internetit të institucionit rezultoi se është publikuar lista e plotë e konferencave shkencore të realizuara. Sugjerojmë që në këtë rast të bëhet publike edhe tabela e përmbajtjes, për çdo konferencë të realizuar, me qëllim rritjen e interesit jo vetëm për studentet e Institucionit por edhe për persona të tjerë të cilët realizojnë kërkim shkencor.

Megjithëse ekziston një rregullore për kërkimin shkencor dhe botimet sugjerojmë që një rregullore e tillë detjohet më tej, ku të gjejnë pasqyrim, mënyra e organizimit të këtyre konferencave, ngritja e bordit shkencor, thirrjet për pjesëmarrje, mënyra e vlerësimit të kumtesave dhe e botimit të tyre etj.

Një tjetër element pozitiv në fushën e kërkimit shkencor është edhe fakti që Institucioni, mbështet personelin e vetë akademik në realizimin e botimeve me karakter shkencor. Në RVB përmenden disa të tilla. Kjo mundëson zhvillimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor, i cili në këtë formë shfaqet edhe më i thelluar. Megjithëse, sic e përmendëm më sipër, ekziston një rregullore për kërkimin shkencor dhe botimet, sugjerojmë detajimin e saj me parashikime që rregullojnë, mënyrën e paraqitjes së tyre, rregullat e drejtëshkrimit, përbërjen dhe detyrat e bordit shkencor që vlerëson rëndësinë shkencore të botimit etj. Po kështu, sugjerojmë që edhe lista e këtyre botimeve, sebashku me tabelën e përmbajtjes të publikohet në faqen e internetit të institucionit me qëllim njohjen e tyre në botën akademike si edhe për personat e tjerë, studies të këtyre fushave.

Një vërejtje që mund të bëhet në këtë rast është pasaktësia e të dhënave të përmendura në RVB. Kështu nga intervista që u realizuan në institucion, rezultoi se deklaratimet e bërë në RVB, ishin për të gjithë universitetin në tërësi dhe jo vetëm për fushën e shkencave juridike. Kjo e bën të vështirë individualizimin e të dhënave që pasqyrohen në këtë raport nëse kanë të bëjnë me Departamentin e Shkencave Juridike apo me struktura të tjera të Universitetit. Psh, në tabelën nr.19, fq.75 e RVB, deklarohen një sërë të dhenash në funksion të kërkim shkencor ku ndër të tjera rezultojnë edhe numër projektsh të fituara 5 dhe numër projektsh të mbyllura 3. Nga intervista rezultoi se ato nuk ishin në fushën e shkencave juridike por në fusha të tjera kërkimore.

Përsa i përket kërkimit shkencor, duhet përmendur edhe fakti se institucioni përgatit një plan vjetor për kërkimin shkencor si edhe në fund të tij hartohet një relacion përkatës ku tregohen arritje të tyre. Një model i tillë na u vu në dispozicion dhe është ngarkuar në platformën elektronike e-ascal.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Institucioni ka lidhur rreth disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të administratës publike, zyra avokatie dhe ndërmjetësimi si edhe me institucione arsimore të huaj. Kjo i shërben rritje dhe kualifikimit të stafit akademik si edhe dhënien e mundësive të shumta për zhvillimin dhe thellimin e njohurive tek studentët.

Këto marrëveshje janë lidhur me Universitetin e Palermos, Universitetin e Pizës, Universitetin e Corvinus, Budapest Hungari, Universitetin e L'Aquillas, Universitetin e MUNA (Mediterranean and Middle East University Network Agreement), Universitetin e IPUS.

Në kuadër të bashkëpunimit, Departamentin e Shkencave Juridike e kanë vizituar personalitete dhe lektorë të të huaj të cilat kanë mbajtur leksione të hapura. Në RVB përmenden dy orë mësimore të tilla. Po kështu, realizimi i këtyre marrëveshjeve ka krijuar mundësinë që studentët të zhvillojnë praktikë mësimore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive praktike në zbatim të ligjit.

Një vërejtje që mund të bëhet në këtë rast lidhet me deklarinimin në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të studentëve të transferuar dhe/apo larguar (tabela nr.20, pika 4, fq.20 e RVB). Duhet sqaruar se keto janë lëvizje stundetore jo në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucionai ka me subjekte të tjera.

Përsa i përket aktiviteve shkencore, për një pasqyrë më të detajuar referojuni ankesit 1, ndërsa përsa i përket marrëveshjeve të bashkëpunimit, referojuni ankesit 2 të këtij raporti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Kriteri 1. Informacioni shkëmbehet rregullisht midis anëtarëve të personelit akademik, si edhe ka një bashkëpunim të mirë, i cili rezulton i dukshëm nga organizimi i konferencave, simpoziumeve, botimeve në Revistën e Optime etj.</p> <p>Kriteri 2. Ka një ndarje të detyrave midis anëtarëve të personelit akademik e cila mundëson marrjen e përgjegjësive dhe garanton bashkëpunimin midis stafit akademik. Po kështu drejtuesi i departamenteve kanë përgjegjësi të qarta në nxitjen dhe vlerësimin e kërkimit shkencor nga stafet e tyre akademike.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Kriteri 1. Megjithëse ka disa marrëveshje bashkëpunimi të deklaruara, nga intervistat e zhvilluara rezultoi se praktika mësimore zhvillohej vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë.</p> <p>Kriteri 2. Marrëveshjet e bashkëpunimit me punëdhënësit, në të dyja gjykatat, rezultojnë që janë të frytshme përsa i përket rritjes së aftësisë dhe zhvillimit të njohurive të studentëve në fushat përkatëse.</p> <p>Kriteri 3. Nga ana e Departamentit të Shkencave Juridike, organizohen seminare me punonjës praktike, në të cilat marrin pjesë edhe studentë. Kjo ndihmon në zhvillimin e njohurive të tyre, por nuk ka një plan të mirëfilltë organizimi të trajnimeve profesionale në bashkërendim me punëdhënësit.</p> <p>Kriteri 4. Rregullisht nga strukturat e Departamentit, hartohen raporte analitike në funksion të programeve të studimit.</p>

Konkluzionet e GVJ

Departamenti i Shkencave Juridike pranë Institucionit, ka krijuar sistem të ndryshme të shkëmbimit të informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. Po kështu janë të ndara përgjegjësit midis drejtuesit të departamentit dhe Dekanit të Fakultetit për nxitjen dhe koordinimin e këtij bashkëpunimi.

Institucioni ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me institucione të administratës publike, gjykata, zyra avokatie, ndërmjtësimi etj, si edhe me institucione të huaja, të cilat mbështesin dhe ndihmojnë realizimin e programave të studimit. Por marrëveshje për realizimin e praktikës mësimore **rezulton se ka vetëm me Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe me Gjykatën e Apelit Tiranë.**

Në këtë këndvështrim standardet plotësohen kryesisht.

Sugjerojmë, lidhjen e marrëveshjeve të reja për zhvillimin e praktikës mësimore edhe në institucione apo organizata të tjera me qëllim diversifikimin e praktikës mësimore.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

Pikët e forta

1. Programi i studimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor si edhe me Kartën e Bolonjës. Programi i studimit janë hartuar bazuar në përvojën akademike më të mirë vendase dhe të huaj. Nëpërmjet botimeve shkencore synohet gjithmonë përmirësimi i literaturës në funksion të këtyre programeve. Me përjashtim të kalimit nga programi 4 vjeçar në atë 3 vjeçar programi i studimit i nuk ka pasur ndryshime të mëtejshme.
2. Punësimi i personelit akademik me kohë të plotë realizohet nëpërmjet procedurave transparente dhe të rregullta të punësimit.
3. Institucioni ndjek një politikë mbështetjeje për kualifikimin shkencor të personelit akademik.
4. Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor monitorohen vazhdimisht nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë e cila ka ngritur një mekanizëm kontrolli të vazhdueshëm dhe periodik duke krijuar praktikat përkatëse.
5. Institucioni ofron literaturë të nevojshme në gjuhën shqipe për zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjithashtu institucioni ka krijuar akses për stafin akademik dhe studentët në librarinë elektronike Questia.
6. Institucioni disponon hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për stafin akademik, stafin administrative dhe për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve.
7. Institucioni ka treguar qendrueshmëri financiare, si edhe aplikon një sistem kontrolli auditit të brendshëm dhe të jashtëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Institucioni ka një bazë të plotë të të dhënave për numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar, të diplomuar, dosjet personale për secilin student si edhe të dhëna për umrin e studentëve të diplomuar në BSc në Shkenca juridike.
9. Institucioni ka miratuar edhe mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për studentë me qëllim pranimit të tyre në studimet universitare.
10. Institucioni ka ngritur strukturat e posacme për koordinimin dhe zhvillimin shkencor. Nga ana e institucionit organizohen konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, workshop-e, seminare simpoziume etj.
11. Institucioni boton rregullisht Revistën Optime, e paisur me ISSN, materialet e referuar në konferenca si edhe materiale studimore të personalit akademik.
12. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi të ndryshme me disa institucione, por përsa i përket praktikës mësimore funksionon marrëveshja vetëm e Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, dhe Gjykatën e Apelit Tiranë.

Pikët e dobta

1. Vetëm një pjesë e stafit akademik me kohë të plotë ka grada/tituj shkencor.
2. Pedagogët japin mësim në më shumë se një lëndë, të cilat shpesh herë i përkasin edhe fushave që janë shumë të ndryshme nga njëra tjetra.
3. Pedagogët, pjesë e stafit akademik efektiv nuk mbulojnë plotësisht ngarkesën mësimore të parashikuar, 70% të orëve mesimore.
4. Të ardhurat financiare bazohen vetëm në tarifat që paguhen nga ana e studentëve, si edhe mungojnë mundësitë për gjenerimin e fondeve nga burime të tjera.
5. Nuk ka kritere shtesë për pranimin e studentëve në këtë institucion.
6. Faqja zyrtare e internetit të institucionit, nuk pasqyron të plotë të gjithë informacionin e kërkuar si edhe aktivitetet shkencore, akademike dhe të botimeve shkencore që realizohen nga ky institucion.
7. Nuk është krijuar, "Klinika e ligjit", si një strukturë e cila do të mundësojë ofrimin e shërbimeve juridike në emër të Institucionit për të tretët, si edhe do të mundësojë ushtrimin e aftësive praktike nga vetë studentët.
8. Mungon zhvillimi i projekteve në fushën e shkencave juridike.
9. Nuk ka një studim të mirëfilltë tregu me qëllim përshtatjen edhe të programeve në funksion të kërkesave të tregut.
10. Praktika mësimore realizohet vetëm në dy institucione (Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë).

Mundësitë

1. Rritja e pjesëmarrjen nëpër projekte të ndryshme, e cila do të aktivizojë si stafin akademik ashtu edhe vetë studentët.
2. Rritjen e alternativave për financimin e institucionit, nëpërmjet projekteve por edhe në realizimin e shërbimeve për të tretët.
3. Shfrytëzimi i mundësive që ofron legjislacioni i ri për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Pengesat

1. Konkurenca me IAL të tjera, publike dhe jopublike, duke sjellë si pasojë largimin e personelit akademik dhe të studentëve.
2. Numri i lartë i universiteteve të ndryshme të cilat ofrojnë këtë program studimi mund të ulë interesin e kandidatëve për studentë në këtë fushë.
3. Mungesa e burimeve financiare alternative.

Recomandime

1. Aktivitetet shkencore dhe profesionale që janë zhvilluar nga studentët dhe pedagogët e Programit BSc në Shkenca Juridike që reflektojnë edhe vlera kombëtare, mund të gjejnë pasqyrim më të plotë në faqen e internetit të IAL "Albanian University".
2. Përcaktimi i qartë i numrit të personelit akademik efektiv apo me kontratë i cili zhvillon procesin mësimor në institucion.
3. Rritjen e numrit të PAE me qëllim angazhimin e tyre në mbi 70% të procesit mësimor.
4. Titullarët e lëndëve duhet që të jenë pjesë e personelit akademik efektiv.
5. Duhet të caktohen më shumë pedagogë për praktikën mësimore me qëllim arritjen e standardeve.
6. Përfshirja në kontratën e punës me personalin akademik e një klauzolë e cila të përcaktojë që anëtari i personelit akademik do të qendrojë mbas marrjes së gradës/titullit shkencor edhe për një periudhë kohore të caktuar pranë këtij institucioni arsimor.
7. Vendorsjen e programeve të studimit në faqen e internetit të Universitetit.
8. Një nga auditorët mund të përshtatet në formën e një salle gjyqi për realizimin e gjyqeve imituese dhe aktiviteteve të tjera akademike.
9. Hartimin e programit të ri të studimit 5 vjeçar, në fushën e Shkencave juridike, sipas kërkesave të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor".
10. Shtimi i disa lëndëve mësimore si "Klinika e Ligjit".
11. Në hartimin e RVB në vijim do të sugjerohej që të dhënat financiare të paraqiteshin të plota sipas elementëve/komponentëve të përcaktuar tek rubrika "Tregues të matshëm".
12. Në të ardhmen mund të shikohet edhe mundësia që një pedagog të mund të japë mësim në lëndë/module ku ka fushën e tij/saj të ekspertizës ose edhe lëndë të tjera të ngjashme.

13. Në të ardhmen Institucioni të përcaktojë kritere shtesë, materialë, për pranimin e studentëve në rritje të cilësisë.
14. Realizimi i një studimi sa më të plotë të kërkesave të tregut të punës.
15. Lidhjen e marrëveshjeve të reja për zhvillimin e praktikës mësimore edhe në institucione apo organizata të tjera me qëllim diversifikimin e praktikës mësimore.

SWOT
BSc in Law,

Strength

1. The study programs are designed in accordance with the requirements of the legislation in force for Higher Education and Research, as well as the Bologna Charter, based on the best domestic and foreign academic experience. Scientific publications of the staff improves constantly the bibliography of these programs, which reflects continuous progress. Except for the transition from the 4-year program to the 3-year program, in this study program there has been no additional changes.
2. Employment of full-time academic staff is carried out through transparent and regular procedures.
3. The institution pursues a policy of support with regards to academic qualification of the staff.
4. Teaching and research is continuously monitored by the Quality Assurance Unit, which has established a continuous and periodic control mechanism.
5. The institution provides the necessary bibliography in Albanian language for the teaching process and has also enabled access to academic staff and students in *Questia* electronic library.
6. The institution has sufficient and appropriate space/facilities for the teaching process and staff.
7. The institution has shown financial sustainability and applies a system of internal and external financial audit control, in accordance with the legislation in force.
8. Institution has a full database for students (*number of registered and transferred students, graduated students, personal/individual files for each student, as well as data for graduate students in BSc in Law*).
9. The institution organizes continuously scientific conferences and other academic & professional activities.
10. The institution publishes regularly its Journal 'Optime', equipped with ISSN, the conferences' referrals as well as studies of the academic staff.
11. The institution has signed cooperation agreements with other institutions but the teaching practice is functioning only on the base of the agreement with the The Court of First Instance and the Court of Appeal in Tirana

Weaknesses

1. Only a part of the full-time academic staff consist of staff that had attained academic degrees/titles and have been engaged with the College from the beginning;
2. The academic staff teach in more than one subject, which often belong to fields that are very different from each other and not correlated between them.
3. The pedagogues whom are parts of the effective academic staff, do not fully cover the state standard, 70% of the teaching hours
4. Financial income/revenues of the College is based solely on fee's students; there is lack of opportunities for generating funds from other sources.
5. There are no additional criteria for the admission of the students in this institution.
6. The official website of the institution does not fully reflect all the information on the University's activity.
7. The 'Law Clinic', it is not yet been established.
8. There is no development of projects from this institution.
9. There is no proper study of the market which will lead in the adapting of the curricula's according to the market demand.
10. Teaching practice is implemented only in two institutions (The Court of First Instance and the Court of Appeal in Tirana).

Opportunities

1. Increasing involvement in various projects, which will engage actively both, the academic staff and students.




2. Increasing sources and alternatives for funding the institution, through projects and by providing services to third parties.
3. Utilization of the opportunities provided by the new legislation on Higher Education and Research.

Threats

1. Competition amongst other public and non-public HEI's, resulting in the mobility of academic staff and students.
2. The excessive number of universities offering law programs can reduce the interest of student's applicants in this field.
3. Lack of alternative financial resources.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm



1. Prof.Asoc.Dr. Mirela Bogdani
2. Doc.Dr.Erind Merkuri

